# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2017 – Numri: 120

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 24 maj 2017**


**PËRMBAJTJA**


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 137, datë 11.5.2017 | Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Ruajtjen e pelikanit kaçurrel (*Pelecanus crispus*) në Shqipëri........................................................... | 6285 |

**URDHËR**
**Nr. 137, datë 11.5.2017**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR RUAJTJEN E PELIKANIT KAÇURREL (*Pelecanus crispus*) NË SHQIPËRI**

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 26 të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Ruajtjen e pelikanit kaçurrel (*Pelecanus crispus*) për periudhën 2016-2021, bashkëlidhur këtij urdhëri si pjesë integrale e tij.

2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve për publikimin e këtij Plani Veprimi në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
**Lefter Koka**




**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR RUAJTJEN E PELIKANIT KAÇURREL (*Pelecanus crispus*) NË SHQIPËRI**

**(2016-2021)**

**2017**

**PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR RUAJTJEN E PELIKANIT KAÇURREL (*Pelecanus crispus*) NË SHQIPËRI**

**(2016-2021)**

Përgatitur nga:

Taulant Bino, Roland Lleshi and Spase Shumka

Me kontributin e:

Alain Crivelli, Stefan Ferger, Sébastien Pinchon, Sajmir Hoxha, Giorgo Catsadorakis

Ne kuadrin e programit te Noé Conservation "Wetland Management and Dalmatian Pelican Conservation in the Mediterranean Basin" ne bashkepunim me Drejtorine e Biodiversitetit dhe Zonave te Mbrojtura ne Ministrine e Mjedisit

# 1. Hyrje

## 1.1 Përshkrimi i llojit

Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) është një nga speciet më të mëdha në botë të shpendëve fluturues dhe lloji më i madh ndër pelikanët. Puplimi gjatë folezimit është në ngjyrë të argjendtë në të bardhë në pjesën e sipërme, i ngjyrosur me gri në sipërfaqen e barkut, me pullë të verdhë të zbehtë në pjesën e poshtme të qafës. Shumë të mëdhenj; në pjesën e poshtme të krahëve mungon ngjyra e e zezë e theksuar e pendëve primare dhe dytësore që shihen në pelikanin e madh të bardhë. Këmba në ngjyrë gri-plumb. Thërret dhe përshpërit tinguj të fuqishëm. Të rinjtë në vjeshtën e parë thuhet se janë të padallueshëm nga të rriturit, të cilët janë tejet gri për shkak të ndërrimit të puplave.

## 1.2 Statusi aktual i ruajtjes

Përpjekjet për ruajtjen e llojit kanë reduktuar ndikimin e kërcënimeve kryesore në Evropë (Crivelli et al. 1997, Barov & Derhé 2011, Onmus et al. 2011, BirdLife International 2012a, Catsadorakis et al. 2015). Megjithatë Pelikani kaçurrel aktualisht është klasifikuar nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) si lloj në gjendje të brishtë (VU). Në Shqipëri Pelikani Kaçurrel konsiderohet si një specie e Rrezikuar në Mënyrë Kritike (Urdher i Ministrit Nr. 146 dated 08.05.2007 as amended) për shkak të numrit të vogël të çifteve riprodhuese dhe shpërhapjes minimale të vendeve të folezimit. Specia ne fjalë ka pësuar një rënie të ndjeshme në numër me një humbje prej 80% të cifteve riprodhuese që prej vitit 1960 në Lagunën e Karavastasë. Zhdukja e tyre graduale është rezultat i drejtpërdrejtë i gjuetisë së paligjshme, shqetësimit me natyrë njerëzore, humbjes së habitateve te folezimit dhe ushqimit si dhe mbishfrytëzimit e degradimit të burimeve natyrore.

## 1.3 Justifikimi i Planit të Veprimit

Ruajtja e Pelikanit kaçurrel në Shqipëri është e domosdoshme sepse Pelikani është një specie e rrezikuar, në nivel global dhe kombëtar dhe një lloj simbol i shpendëve në Shqipëri dhe më gjerë. Kjo e ngarkon Shqipërinë me një detyrim të rëndësishëm për të mbrojtur Pelikanin kaçurrel.

Nga ana tjetër, Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (2016-2020) thekson se Ministria e Mjedisit inkurajon hartimin e planeve të veprimit për llojet e rrezikuara. Në këtë kuptim, edhe për Pelikani kacurrel inkurajohet hartimi i Planit të Veprimit për ruajtjen e tij nga faktorët kërcënues.

Përveç sa më sipër, Pelikani kacurrel është lloj i Aneksit të I-rë të Direktivës Europiane të Shpendëve (Direktiva 2009/147/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 30 Nëntorit 2009 Për Ruajtjen e Shpendëve të Egër. Ky Aneks jep listën e llojeve që duhet të jenë subjekt i masave të veçanta të ruajtjes, për sa i takon habitateve të tyre, në mënyrë që të sigurohet mbijetesa dhe riprodhimi në zonën e tyre të përhapjes.

Gjithashtu, përpjekjet e ndryshme për ruajtjen e llojit në Shqipëri, të nisura që prej vitit 2000, duket se nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar rritjen e qëndrueshme të tij. Megjithë mbrojtjen e shumicës së zonave të përhapjes dhe masave të tjera të konservimit të ndërmarra, kërcënimet janë ende të pranishme, veçanërisht në lidhje me shqetësimin njerëzor gjatë sezonit të riprodhimit nga peshkatarë ilegalë apo turistë të rastit, ndryshimet hidrologjike që çojnë në erozion të ishullit të folezimit dhe përmbytje të kolonisë, eutrofikim në rritje të ekosistemeve ligatinore si dhe humbje e habitatit për ushqim dhe riprodhim.

Bazuar në sa më sipër, Plani aktual i Veprimit, është një prioritet kombëtar dhe zbatimi i tij do të përmirësojë statusin e ruajtjes së llojit në Shqipëri dhe në zonën e shpërndarjes së llojit.

## 2. Pelikani Kaçurrel në Shqipëri

Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus)* është specie e përhershme në Shqipëri, me shpërndarje të reduktuar tashmë si pasojë e humbjes së habitateve jetike.

### 2.1. Shpërndarja e mëparshme

Pelikani kacurrel ka qenë mjaft i përhapur në Shqipëri deri në fundin e viteve 50'. Zonat e tij të dimërimit përfshinin ish-kënetat e Durrësit (Ticehurst dhe Whistler 1932), Tërbufi afër Lushnjës (Bernatzik 1930), grykëdedhjen e lumit Mat (Thorpe et al. 1936 Kattinger 1958) dhe Liqenin e Shkodrës (Ticehurst dhe Whistler 1932). Burime të tjera kanë konfirmuar praninë e tij në pjesën tjetër të ligatinave bregdetare të Shqipërisë, si dhe në liqenet e Shkodrës, Ohrit dhe Prespës.

| Harta mbi zonat e dimërimit |
|---|

Vëzhgimet gjatë sezonit të folezimit kanë raportuar dhe konfirmuar riprodhimin e Pelikanit kacurrel në Lagunën e Karavastasë (Lodge 1908, Bernardzik 1930, Thorpe *et al.* 1936) ish-kënetat e Maliqit (Bernardzik 1930, Thorpe et al. 1936). Burimet lokale, të cituara nga autorë të ndryshëm, kanë sugjeruar folezimin të mundshëm në grykëderdhjen e lumit Mat, kënetën e Tërbufit dhe lagunën e Nartës, por këto të dhëna nuk janë konfirmuar nga burime të tjera.

| Harta mbi zonat e riprodhimit |
|---|

Të gjitha ligatinat e përmendura më sipër kanë qenë gjatë viteve 1950-1970 subjekt i programeve të mëdha të kullimit dhe kthimit në toka bujqësore,. Këneta e Maliqit dhe kënetat e Durrësit dhe Tërbufit u thanë plotësisht. Pjesë të vogla janë kthyer në toka bujqësore edhe në Patok (Grykëderdhja e Matit) dhe Karavasta. Si rrjedhojë, numri i Pelikanëve u reduktua në masë të madhe. Vendet e vetme të mbetura ku folezimi vazhdonte ende, cilësisht Karavastaja dhe Prespa e Vogël (Proko *pers. obs.*), kanë qenë subjekt i mëtejshëm i degradimit të habitateve, shqetësimit njerëzor dhe gjuetisë së paligjshme.

Kolonia e Prespës së Vogël u braktis gjatë viteve 1990 (Malltezi 2001, A. Proko *pers. obs.*). Ka shumë të ngjarë që braktisja të jetë shkaktuar kryesisht nga shqetësimi njerëzor por edhe faktorë të tjerë si thatësira dhe grabitqarët.

### 2.2. Evolucioni i kolonisë ekzistuese

Të dhënat e para mbi shpendët riprodhues në Karavasta janë ofruar nga Lodge (1908). Autori raporton 250 fole me vezë dhe zogj në tre ishuj ranor në lagunë. Vendi i folezimit është i njëjtë me vendndodhjen e sotme të kolonisë, i njohur nga vendasit si "Ishulli i Bazhorrit" ose "Ishulli i Pelikanëve".

Lamani (1989) në vitet 60' vëren pothuajse të njëjtin numër çiftesh riprodhuese dhe shënon 200-250 fole duke treguar se deri në atë kohë kolonia e Pelikanit kacurrel në Divjakë-Karavasta ka qenë pak a shumë e stabilizuar.

**Figure 1. Evolucioni i kolonise se *Pelecanus crispus* ne Divjake-Karavasta (1905-2016)**




ë

Të dhënat nga 1984 deri më sot janë më të rregullta. Ato tregojnë se kolonia ishte në rënie të vazhdueshme (Fig.1) deri në vitin 2003. Në pranverën e vitit 1984, Vangeluëe et al. (1996) ka raportuar 81 fole. Ky numër paraprihet nga një fushatë e sektorit të peshkimit, në fillim të viteve 80', për shkatërrimin e foleve, thyerjen e vezëve dhe eliminimin e të vegjëlve. Asokohe politikat e peshkimit konsideronin Pelikanin si konkurrent të peshkimit.

Crockford & Sutherland vëzhguan në vitin 1991 një numër prej 52 folesh, të ndara në disa nënkoloni të vogla. Gjatë 1992-1996, numri i riprodhuesve luhatej midis 52 dhe 62 çifteve folezuese (Peja et al. 1996, Bino 2003 dhe M. Stefi *pers. com.*) duke mos treguar asnjë trend të qënësishëm. Pas vitit 1997, vërehet një ulje prej gati 50% e numrit të foleve, besojmë e lidhur kryesisht me vrasjen e të rriturve nga gjuetia e paligjshme. Kjo tendencë gjuetie dhe e rënies së numrit është ndjekur për një numër vitesh duke arritur nivelin më të ulët në vitet 2001-2003 me vetëm 19 çifte riprodhuese.

Që prej vitit 2003 e më pas, kolonia ka shënuar një tendencë në rritje, e cila arrin kulmin e saj në vitin 2016 me 52 çifte riprodhuese. Trendi i fundit mbështetet në përpjekjet për ruajtjen e species të ndërmarra që prej fillimit të viteve 2000 por veçanërisht që nga viti 2014 kur kolonia është menaxhuar dhe ruajtur në mënyrë të vazhdueshme duke rezultuar kështu në një ulje të ndjeshme të shqetësimit me natyrë njerëzore.

**2.3. Shpërndarja ekzistuese përgjate sezonit të dimrit**

Kompleksi ligatinor Divjakë-Karavasta është zona kryesore e dimërimit të Pelikanit kacurrel në Shqipëri me mesatarisht 140 shpend dimërues. Ndërkaq, efektivat dimëruese në Shqipëri luhaten nga 82 në 260 me një mesatare shumëvjecare prej 156 individësh.




Zona të tjera të rëndësishme për dimërimin ë tij në Shqipëri janë, sipas rëndësisë, Liqeni i Thanës (Berat), Laguna dhe Kriporet e Nartës (Vlorë) si dhe Liqenet Prespë e Madhe dhe Prespë e Vogël.

## 3. Biologjia e riprodhimit të Pelikanit kaçurrel

### 3.1. Riprodhimi

Sjellja joshëse fillon zakonisht në janar. Të rriturit formojnë koloninë në gjysmën e dytë të janarit dhe fillim të shkurtit. Vezët depozitohen zakonisht 10 ditë më vonë. Sipas Crivellit et al. (1997) shpendët depozitojnë deri në tre vezë, ndërsa mesatarja është 1.8 vezë për fole. Inkubimi zgjat 31 deri në 32 ditë dhe fluturimi i të vegjëlve (fluturak) arrihet 11 deri në 12 javë pas çeljes së vezëve. Suksesi i çeljes varion nga 35% deri në 70% të vezëve. Suksesi i riprodhimit (llogaritur si numri i fluturakëve/numrin e foleve) është shumë i ndyshueshëm. Në kolonitë e ruajtura mirë suksesi i riprodhimit është mbi një zog për fole deri në një maksimum prej 1.5 (Catsadorakis & Crivelli 2001). Edhe në Karavastasa suksesi i riprodhimit ka qenë subjekt i luhatjeve shumë të larta nga 0.21 në 1996 (Peja et al 1996;. M. Stefi *kom. pers.*) në 1.17 fluturakë për fole në vitin 1999.

Sipas Crivellit (1994), suksesi i riprodhimit prej 0.8 fluturakëve për fole duhet të jetë i mjaftueshëm për të mbajtur një koloni në gjendje të qëndrueshme, ndërsa një shkallë suksesi mbi një fluturak për fole duhet të sigurojë një popullatë në rritje.

### 3.2. Dimërimi

Zonat kryesore të dimërimit të Pelikanit kaçurrel janë të vendosura në zonat bregdetare të Detit Mesdhe, Detit Kaspik si dhe në Gjirin Persik (Crivelli 1994). Në Shqipëri, zona më e rëndësishme e dimërimit është Kompleksi i Karavastasë, me rreth vitit 90% të individëve dimërues (Bino i pabotuar).

Unazimet kanë treguar se shpendët që riprodhohen në Shqipëri mund të dimërojnë gjithashtu në Kriporet e Ulqinit (Mali i Zi) dhe në deltat e lumit Kallamas dhe Gjirin e Ambrakisë në Greqinë jug-perëndimore (Saveljic & Rubinic 2009).

### 3.3. Ushqimi

Pelikanët kacurrel të rritur hanë vetëm peshk dhe ushqehen vetëm ose në grupe (Crivelli et al. 1991). Përbërja e dietës së tij është studiuar në detaje në koloninë e Karavastasë (Peja et 1996). Ngjala (*Anguilla anguilla*), Qefulli (*Mugil* sp.) dhe Burdullaku (*Gobius bucchichi*) janë preja kryesore. Lloje të tjera, përfshirë Levrekun (*Dicentrarchus labrax*), Kocen (*Sparus aurata*), Shpalcën (*Pagrus pagrus*) dhe Gaforren e zakonshme (*Carcinus aestuarii*), konsumohen por më rrallë.

Dieta e të vegjëlve është pak më e ndryshme nga të rriturit. Të paktën gjatë ditëve të para të jetës së tyre, të vegjlit ushqehen me karkaleca deti (vrojtim personal Bino). Dieta ndryshon me moshën e të voglit. Ngjalat dhe qefujt e vegjël mbizotërojnë deri në 1-2 javë pas çeljes së vezëve. Pas kësaj periudhe dieta bëhet e ngjashme me atë të të rriturve.

### 3.4. Kërkesat për habitat

Pelikani kaçurrel ka nevojë për vende të sigurta riprodhimi, fjetje dhe qëndrimi. Këto vende janë të rrethuara me ujë dhe në këtë mënyrë të izoluara tërësisht nga toka për të shmangur grabitqarët si dhelprat, çakejtë, qentë dhe macet rrugaçe si dhe ndërhyrjet e njeriut (Crivelli 1987). Mungesa e vendeve të përshtatshme për fjetje dhe qëndrim bën që pelikani të mos e përdorë një sipërfaqe të caktuar në çdo kohë të vitit.

Regjimi hidrologjik i ligatinave është një tjetër faktor i rëndësishëm për suksesin e të ushqyerit dhe riprodhimit. Sipas Catsadorakis *et al.* (1996) efektet e thatësirës në liqenin e Prespës së Vogël lejuan ndërhyrjen e grabitqarëve dhe kanë patur një efekt negativ në suksesin e riprodhimit të pelikanëve të vendosur pranë kufirit shqiptar.

Sipas Crivelli (1994), transparenca e ujit dhe thellësia nuk janë faktorë të rëndësishëm për një kërkim të suksesshëm të ushqimit.

## 4. Kërcënimet ndaj Pelikanit kacurrel

Në bazë të vlerësimeve të ndryshme, raporteve dhe publikimeve për Pelikanët kacurrel në rajon dhe në Shqipëri (Crivelli et al., 1988; 1991; 1998; Catsadorakis et al. 2001; Bino 2003; Munari et al., 2009; Bino et al. 2010; Kallfa 2010; Catsadorakis et al., 2015) kërcënimet kryesore për Pelikanin në Shqipëri janë:

- Shqetësimi nga njeriu
- Gjuajtja e të rriturve, shkatërrimi i foleve
- Humbja apo degradimi i habitateve ushqyese
- Humbja dhe degradimi i zonave të folezimit
- Stuhitë dhe përmbytjet për shkak të situatave ekstreme të motit
- Ndotja nga metalet e rënda dhe pesticidet
- Ndikime nga Ndryshimi i Klimës Globale
- Përplasja me linjat e energjisë elektrike

### 4.1 Shqetësimi i njeriu

**Rëndësia: Kritike**

Shqetësimi, që ndodh përgjithësisht gjatë sezonit të riprodhimit dhe vjen nga peshkatarë dhe gjuetarë të paligjshëm, turistë dhe fotografë, ka qenë konsideruar deri në vitet e fundit si faktori kryesor kufizues për Pelikanin kaçurrel në Karavasta dhe Shqipëri. Kolonia në Karavasta shqetësohet kryesisht gjatë natës, nga peshkatarët e paligjshëm që kanë si qëllim peshkimin në rrethinat e Ishullit të Pelikanit. Shqetësimi ndodh edhe gjatë ditës, por në raste shumë të kufizuara.

Megjithë rëndësinë kritike, duket se shqetësimi ka shenja të rëndësishme të reduktimit për shkak të ruajtjes së kolonisë gjatë natës. Nga ana tjetër, përpjekjet e derisotme për ndërgjegjësim publik po japin tashmë rezultatet e tyre pasi vendasit kanë filluar të kuptojnë se prania e Pelikanit kaçurrel është një aset shumë i rëndësishëm turistik për të gjithë zonën e Divjakë-Karavastasë.

### 4.2 Gjuatja e të rriturrve dhe juvenilve, shkatërrimi i foleve, eleminimi i të vegjëlve, thyerja e vezëve

***Rëndësia: Mesatare***

Shkatërrimi i vezëve dhe foleve ka qenë dukuri e zakonshme deri në fundin e viteve 1990', pavarësisht mbrojtjes ligjore të Pelikanit kacurrel dhe faktit se Karavastasja është caktuar Zonë Ramsar që në vitin 1994.

**Gjuajtja e të rriturrve** të Pelikanit kaçurrel është reduktuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit si rezultat i zbatimit të rreptë të ndalimit të gjuetisë që rrjedh nga legjislacioni për Zonat e Mbrojtura dhe Zonat e Rëndësishme të Shpendëve. Në përputhje me legjislacionin e përmendur më lartë, gjuetia nuk është e lejuar në Zonat e Mbrojtura, si dhe në Zona të Rëndësishme për Shpendët (Neni 11 "Zonat ku gjuetia është e ndaluar" të ligjit nr 10253, datë 11.3.2012 "Për gjuetinë" dhe Urdhri i Ministrit Nr 283, datë 10.04.2013 "Për miratimin e ligatinave bregdetare që shërbejnë si habitate për shpendët shtegtarë"

**Shkatërrimi i qëllimshëm i foleve, eleminimi i të vegjëlve, thyerja e vezëve ka ndodhur** rëndom në vitet 1980', por sot ky fenomen nuk ekziston më. Përkundrazi, autoriteti i Administratës Rajonale për Zonat e Mbrojtura (ARZM) Qarku Fier, të mbështetura nga projekti "Menaxhimi i Ligatinave dhe Ruajtja e Pelikanit Kaçurrel në Pellgun e Mesdheut", kanë ndërtuar sot platforma artificiale të folezimit dhe po mbështetet folezimin e Pelikanit nëpërmjet ndihmës me material folezues të përbërë nga degë pishe (*Pinus* sp.) dhe kripthi (*Salicornia* sp.).

### 4.3. Humbja dhe degradimi i habitateve të ushqimit

**Rëndësia: Kritike**

Humbja e habitatit ka qenë faktori më i spikatur deri në fundin e viteve 1960', përgjegjës për pakësimin e Pelikanit kaçurrel në Shqipëri. Kjo pasi shumë ligatina u thanë apo u drenazhuan për të krijuar toka të reja bujqësore. Për pasojë shumë prej Pelikanëve humbën zona të mëdha të dimërimit dhe folezimit. Edhe sot humbja dhe degradimi i habitateve ligatinore mbetet një faktor kritik.

Ekosistemi ligatinor i Karavastasë po kërcënohet së fundmi nga disa projekte zhvillimi që synojnë zhvillimin e turizmit në Zonat Qendrore të Parkut Kombëtar të Dijakë-Karavastasë dhe që nuk respektojnë statusin e Zonës së Mbrojtur dhe kuadrin ligjor kombëtar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Përvec kësaj ndërhyrjet rrezikojnë të sjellin ndryshime në hidrologjinë dhe limnologjinë e lagunës me pasojë rritjen e eutrofikimit dhe demtimin e biodiversitetit ujor.

Laguna e Nartës, një tjetër zonë e rëndësishme për dimërimin e Pelikanit kacurrel në Shqipëri, është e kërcënuar nga zhvillimi i industrisë së naftës.

Ndërhyrjet hidrologjike në Liqenin e Prespës së Vogël kanë rritur sedimentimin e të gjithë ekosistemit të liqenit. Pjesa shqiptare e liqenit, në afërsi të fshatit Zagradec (Buzëliqenas) është thuajse e humbur dhe një pjesë e saj është kthyer në tokë bujqësore. Sedimentimi i lidhur me thatësirën e shkaktuar prej ndryshimit të klimës ka favorizuar aksesin e grabitqarëve tokësorë dhe së bashku me shqetësimin e rritur nga aktivitetet njerëzore, përmbytjet e forta të vitit 1991 dhe shfaqjes së zonave shumë

produktive të ushqimit në bashkimin e dy liqeneve të Prespës, janë ndoshta shkaku i dikurshëm i braktisjes së kolonisë afër kufirit greko-shqiptar.

Shumë prej ekosistemeve bregdetare lagunore kanë në mënyrë të vazhdueshme komunikim të reduktuar me detin dhe për pasojë rritje të niveleve të eutrofikimit. Të tilla janë sidomos rastet e Lagunës së Karavastasë dhe Lagunës së Nartës ku ka pasur shpesh ngordhje masive të peshkut dhe për pasojë reduktim të burimeve ushqimore për Pelikanin.

### 4.4. Humbja dhe degradimi i zonave të folezimit

**Rëndësia: Kritike**

Catsadorakis dhe Crivelli (2001) duke u përpjekur për të kuptuar faktorët që kufizojnë numrin e Pelikanëve folezues, gjetën tregues të fortë për të provuar se cilësia, disponueshmëria dhe shpërndarja hapësinore e ishujve të folezimit kanë ndikuar në performancën e tyre të përgjithshme të riprodhimit.

I njëjti fenomen duket se shfaqet dhe në Shqipëri. Këneta e Maliqit (Korcë) së bashku me territoret e riprodhimit të Pelikanit Kacurrel, humbi si rezultat i tharjes së kenetes për tu kthyer në tokë bujqësore. Vendet e mundshme të folezimit në Prespën e Vogël humbën përmes ndryshimeve të regjimit hidrologjik dhe djegies së kallamishteve. Për më tepër, djegiet me qëllim ringjalljen e kallamit të ri, dalin shpesh jashtë kontrollit dhe mund të shkatërrojnë habitate potenciale të riprodhimit për Pelikanët.

Ndërkohë, ishujt e përdorur për folezim në ligatinat bregdetare të Karavastasë vuajnë nga degradimi i lidhur me ndryshimet e regjimit natyror të sedimentimit, erozioni si pasojë e vetë aktivitetit të shpendëve, përdorimi i bimësisë për ndërtimin e foleve dhe efektet ekstreme të motit, sikundër stuhitë, ndoshta të përforcuara nga ndryshimi klimës.

### 4.5. Përmbytjet e vendeve të folezimit për shkak të situatave ekstreme të motit

***Rëndësia: Kritike***

Përmbytja e ishullit të riprodhimit të Pelikanit në Karavasta është një ngjarje e shpeshtë që ndodh zakonisht një ose dy herë në sezonin e riprodhimit dhe shkakton zakonisht përmbytjen e foleve të vendosura shumë afër me ujin. Përmbytjet mund të shkatërrojnë foletë ose të vrasin embrionet në vezë apo të vegjlit në moshë fare të re.

Përmbytjet ndodhin zakonisht gjatë ngjarjeve ekstreme të motit si stuhiteë, shirat e rrëmbyer që vijnë nga jugu. Nëse e gjithë kjo kombinohet me baticë të lartë, efekti i përmbytjeve është edhe më i theksuar dhe mund të jetë shkatërrimtar për koloninë sepse disa prej cifteve të Pelikanëve mund të dështojnë tërësisht në shumimin e tyre. Rasti më i fundit është ai i vitit 2014 kur kolonia qëndroi për një kohë të gjatë e përmbytur dhe nje pjesë e mirë e pjelljeve humbën si pasojë e lagies së vezëve (Bino *pers. obs.*).

Bazuar në sa më sipër duket se shmangia e efektit të përmbytjeve është një faktor i rëndësishëm për suksesin e riprodhimit.

### 4.6. Ndotja nga metalet e rënda dhe pesticidet

***Rëndësia: Mesatare***

Ndotja nga pesticidet ka shkaktuar uljen e trashësisë së lëvozhgës së vezës në Prespë n e Vogël (Crivelli *et al*. 1989) ndonëse dhjetë vjet më vonë është vënë re një rënie shumë të madhe e ndotësve (Crivelli *et al* 1999). Prania e metaleve të rënda në hidrokarburet e klorinuar është edhe shkaku i një suksesi të vogël të çeljes në kolonitë e shpendëve në Detin Aral (Poslavsky & Chernov 1994).

Studime mbi praninë e pesticideve dhe metaleve të rënda në vezët e Pelikanit kaçurrel në Karavasta kanë treguar se përqendrimet mbeten të ulta (Koci *et al*. 1998, Marku et al. 2002).

Gjatë viteve të fundit nuk ka të dhëna mbi sasinë e pesticideve të përdorura nga fermerët lokalë por mendohet që ka rritje si pasojë e intensifikimit te aktivitetit bujqësor në përgjithësi e sidomos në zonën e Divjakës në vecanti.

Ndonëse nuk ka shkarkime industriale në lagunën e Karavastasë, vërehet se rivënia ne funksionim e kanaleve kulluese dhe përmirësimi i lidhjes së tyre me Lagunën e Karavastasë rrezikon të rrisë praninë e përqëndrimeve të metaleve të rënda dhe ndotësve të tjerë në ujëra dhe më pas në përmbajtjen e lëvozhgës së vezës dhe të vetë vezës.

### *4.7. Ndikime nga Ndryshimi i Klimës Globale*

**Rëndësia: Mesatare**

Ngrohja globale mund të ketë një ndikim negativ mbi Pelikanët në bregdetin shqiptar. Me rritjen e nivelit të ujit, vendet e përshtatshme për folezim do të jetë me siguri në rrezik. Ata do të jenë subjekt i përmbytjeve dhe erozionit. Erozioni i vendeve të folezimit është tashmë një problem i madh për t'u menaxhuar për Shqipërinë (observim personal Bino.). Ky problem është edhe më i prekshëm për shpendët folezues të mëdhenj që kanë nevojë për vende folezimi shumë të qëndrueshme.

Në të kaluarën ishulli i Pelikanit në Karavastaka qenë objekt i përmbytjeve gjatë shirave të dendur. Ngrohja globale do të rrisë me siguri rrezikun e përmbytjeve. Por mund të ketë dhe efekte pozitive sepse dimri i ngrohtë mund të zvogëlojë vdekshmërinë gjatë dimrit të pelikanëve dhe te rrisë mbijetesën e tyre.

***4.8. Dëmtimet nga sëmundjet, përplasja me linjat e energjisë elektrike dhe faktorë të tjerë***

***Rëndësia: E panjohur***

Ka disa raste të raportuara të gjetjes së pelikanëve të dëmtuar si pasojë e sëmundjeve apo dhe faktorë të tjerë ende të panjohur. Ne dy rastet e vitit 2016, duket se individët e gjetur vuanin nga botulizmi. Ndonëse në mungesë të një qendre të vecantë rehabilitimi të dy rastet u rikuperuan si pasojë e përkujdesjes se stafit te ARZM Fier.

Vec kësaj ka raportime dhe të përplasjes së pelikanëve me linjat elektrike ndonëse efekti i plotë i tyre mbetet ende i panjohur për shkak të mungesës së hulumtimeve të detajuara.

Megjithatë mendohet që linjat elektrike në Divjakë dhe në kriporet e Nartës mund të jenë vërtet vrastare për Pelikanët që përdorin këto territore. Rasti më i fundit është ai i një Pelikani të plagosur nga përplasja në verën e vonët të 2015. Këto raste mund të shtohen në numër nëse planet për rinovimin e linjave elektrike nuk përfshijmë masa për kalimin e tyre nëntokësor apo aplikacione teknike që perjashtojnë mundësitë e përplases së shpendëve me linjat elektrike.

Gjithashtu gjetjet dhe rekuperimi i pelikanëve të dëmtuar shtrojnë nevojën për ngritjen në parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta të një qendre rehabilitimi te shpendëve që do ti shërbente dhe rasteve të tjera te rekuperimit te shpendëve në Shqipëri.

## 5. Masat aktuale të ruajtjes

Masa të ndryshme të ruajtjes janë ndërmarrë gjatë dy dekadave të fundit. Ato kanë përfshirë rritjen e kapaciteteve institucionale dhe njerëzore për mbrojtjen e natyrës dhe biodivesitetit, mbrojtjen e zonave kryesore të përhapjes së llojit etj.

Përvec tyre, në sajë të Programit "Menaxhimi i Ligatinave dhe Ruajtja e Pelikanit kaçurrel në Basenin Mesdhetar » të zbatuar që prej vitit 2014 dhe i drejtuar nga Fondacioni NOE Conservation, Parku Kombëtar i Divjakë-Karavastasë është përzgjedhur si zonë pilot në të cilën janë ndërmarrë disa aktivitete menaxhuese dhe konservuese ne bashkëpunim të ngushtë me institucionet kombëtare, administratatën e Parkut Kombëtar, autoritetet vendore, PPNEA, INCA dhe organizata të tjera partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

Aktivitetet e ndërmarra nga ky program përfshijnë mbrojtjen e kolonisë së Pelikanit kacurrel, përmirësimin e njohurive mbi llojin dhe habitatet e përdorura prej tij, menaxhimin e vendeve të folezimit të llojit dhe angazhimin e komuniteteve vendore në zhvillimin e qëndrueshëm.

**5.1. Rritja e kapaciteteve institucionale për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit**

Krijimi, në vitin 2014, i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (duke vepruar në nivel rajonal nëpërmjet administratave të saj rajonale) është një hap i rëndësishëm për ruajtjen e natyres por edhe të habitateve kritike për Pelikanin kacurrel, pasi për një kohë të gjatë zonat e mbrojtura janë përballur me nevojën e sovranitetit në funksionimin dhe administrimin e zonave të ndryshme.

**5.2. Mbrojtja e zonave kyçe të shpërndarjes**

a) Laguna e Karavastasë, zona e vetme e folezimit të Pelikanit kacurrel në Shqipëri është shpallur Zonë Ramsar apo Ligatinë e Rëndësisë Ndërkombëtare që prej vitit 1995 si dhe është që prej 2007 është pjesë e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 687 datë 19/10/2007 «Për shpalljen, me sipërfaqe të zgjeruar, të ekosistemit natyror Divjakë-Karavasta «Park Kombëtar».

b) Liqenet e Prespës janë shpallur Park Kombëtar në vitin 1999. Në vitin 2013, zona u përcaktua edhe si Zonë Ramsar.

c) Butrinti është shpallur Park Kombëtar që prej vitit 2005, pas emërtimit të tij zonë Ramsar në vitn 2003.

d) Në vitin 2005 pjesa Shqiptare e liqenit të Shkodrës, rrjedha e lumit Buna, delta e saj dhe zonat bregdetare, si dhe pjesa e saj në bregdetin Adriatik, janë shpallur pjesë e Zonës së Peisazhit të Mbrojtur (Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 682, datë 02.11.2005). Më pas, ne vitin 2006, këto zona u përfshinë gjithashtu në rrjetin e Zonave Ramsar.

e) Pjesa më e madhe habitateve të përhapjes së Pelikanit kacurrel janë tashmë pjesë e rrjetit kombëtar të Zonave të Rëndësishme për Shpendët (IBAs).

f) Në total, mbi 90 % e zonave kyçe të ruajtjes së Pelikanit kaçurrel në Shqipëri, kanë një status të mbrojtur, por shkalla e zbatimit të kësaj mbrojtje ligjore varion gjerësisht në varësi të zonave.

g) Ndalim ligjor i gjuetise per periudhen 2014-2021. Parlamenti miratoi fillimisht një ndalim dy vjecar (2014-2016) që u pasua nga një ndalim tjetër për periudhën 2016-2021.

**5.3. Mbrojtje e kolonisë së Pelikanit kacurrel**

a) Ruajtje e kolonisë së Pelikanit kacurrel me një sistem prej 3-5 rojesh gjatë periudhës janar-maj.

b) Krijimi i zonës me akses të kufizuar në një distance prej 200 metrash prej ishullit. Vendosje bovash sinjalizuese dhe tabela të mëdha informimi në zonën e ndaluar.

c) Kontroll për të eliminuar rastet e gjuetisë së paligjshme.

**5.4. Njohje më e mirë e Pelikanit kaçurrel dhe habiteteve të përdorur prej tij për mbrojtje më të mirë të llojit dhe të ligatinave ku ai gjendet.**

a) Monitorimi i duhur dhe vlerësim i suksesit të riprodhimit për koloninë e Pelikanit kaçurrel në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta.

b) Raportim i vazhdueshëm i të dhënave në lidhje me koloninë e Pelikanit kaçurrel dhe ndarje e informacionit me partnerë të tjerë.

c) Studim i gjendjes ekologjike të Lagunës së Karavastasë dhe Godullës së Jashtme.

d) Studimi i stokut të peshkut në Lagunën e Karavastasë

**5.5. Përmirësimin e kapaciteteve njerëzore për një mbrojtje më të mirë të llojit**

d) Organizim i vizitave shkëmbyese në vende partnere për të njohur dhe ndarë praktikat më të mira të ruajtjes së Pelikanit kaçurrel dhe menaxhimit të ligatinave.

e) Ndërtim i strukturave artificiale të folezimit për Pelikanin Kaçurrel. Strukturat përfshijnë platforma artificiale për folezim dhe furnizim të përvitshëm të ishullit të folezimit në Divjakë-Karavasta me materiale folezuese (degë, shkarpa dhe mbulesë bimore) për të lehtësuar folezimin dhe shmangur përmbytjet.

**5.6. Angazhimi i komuniteteve dhe autoriteteve lokale në zhvillimin e qëndrueshëm**

a) Promovim i praktikave më të mira të peshkimit në Lagunën e Karavastasë.

b) Ndërtim i pese kullave të vëzhgimit të shpendëve në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta. Ndërtimi i tyre i shërben promovimit të turizmit të qëndrueshëm të bazuar në vrojtimin e shpendëve.

c) Trainimi i guidave eko-turistike për të shoqëruar turistët që vizitojnë Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta.

d) Trainimi i vëzhguesëve të rinj për të rritur kapacitetet në lidhje me identifikimin e shpendëve.

e) Organizimi i "Ditës së Pelikanit" në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit lokal, autoriteteve relevante dhe aktorëve të ndryshëm për ruajtjen e Pelikanit kaçurrel dhe biodiversitetit.

f) Përgatitje një Planit ë menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta i cili po zbatohet nga Bashkia e Divjakës.

g) Ndihmesë nga komunitetit të grave me aktivitete të bujqësisë organike në zonën e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.

h) Hartimi dhe shpërndarja e një Kodi të Sjelljes për vizitorët e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.

## 6. Qëllimi dhe Objektivat e Ruajtjes

Plani kombëtar i veprimit për ruajtjen e Pelikanit kaçurrel (*pelecanus crispus*) në Shqipëri ka një jetëgjatësi 5 vjecare nga koha e miratimit të tij nga institucionet përgjegjëse ndërsa rishikimi i tij pritet të kryhet vitin e tretë të zbatimit. Plani ka tre synime në shkallë kohore të ndryshme përfshirë afat-shkurtër, afat-mesme dhe afat-gjatë. Për çdo qëllim janë dhënë objektivat e menaxhimit, arritja e të cilave do të kërkojë një seri veprimesh të përshkruara më poshtë.

### 6.1. Qëllimi

Qëllimi kryesor për planin e veprimit është të ruajë dhe të përmirësojë habitatet e folezimit dhe dimërimit me qëllim rritjen e populates se Pelikanit kacurrel ne Shqipëri në nivelet e viteve 1960'.

### 6.2. Objektivat

*O1. Të rrisë popullatën folezuese të Pelikanit kaçurrel në Karavasta.*

*Arsyetimi:* Popullatat e Pelikanit kaçurrel folezues në Shqipëri kanë qenë të paqëndrueshme në 25 vitet e fundit me luhatje të forta të vërejtura në Lagunën e Karavastasë. Shtimi i popullatës në ditët e sotme është lokalizuar vetëm në lagunën e Karavastasë dhe numri i saj prej 52 çiftesh në vitin 2016 është thuajse i njëjtë me fillimin e viteve 1990' por shumë më i pakët sesa fillimi i viteve 1960'.

*O2. Të mbrojë dhe të ruajë habitatet kritike të Pelikanit kacurrel në Shqipëri dhe të sigurojë një shtesë të vendeve të folezimit aty ku kjo është e mundur.*

*Arsyetimi:* Mbrojta dhe ruajta e habitateve kritike është shumë e rëndësishme për të rritur popullsinë e Pelikanit kaçurrel në Shqipëri. Konvertimi i Prespës së Vogël nga vetëm zonë aktuale ushqimi edhe në vend riprodhimi, sikurse para viteve 1990' është gjithashtu e rëndësishme për shtimin e species në Shqipëri. Ndërsa disa nga zonat nuk mund të mbështesin më praninë e Pelikanit (ish-kënetat e Maliqit, Durrësit dhe Tërbufit), krijimi i kolonive të reja dhe ruajtja e habitateve që përdoren nga specia ne fjalë duket të jetë një kërkesë për të gjithë ekosistemet e tjera ku Pelikani ka qenë i pranishëm. Ky process duhet të shoqërohet domosdoshmërisht me ruajtje të vendeve të mundshme të folezimit.

## 7. Veprimet për Mbrojtjen e Species dhe të Habitateve Kritike

Veprimet konservuese që do të ndërmerren janë grupuar në gjashtë nëndarje kryesore, duke përfshirë:

- Përmirësimin e politikave dhe të legjislacionit,
- Menaxhimin e llojit dhe ruajtjen e habitateve,
- Monitorimin e efektivave të pelikanit kacurrel,
- Nxitjen e edukimit dhe trainimit për ruajtjen e mëtejshme të Pelikanit kacurrel,

- Nxitjen e aktiviteteve ndihmuese e të qëndrueshme *dhe*
- Bashkëpunim i Administratës së Zonave të Mbrojtura me subjektet e tjera.

## A. Përmirësim i politikave dhe legjislacionit

### A.1. Përmirësim i ligjit dhe zbatim i plotë i tij

Legjislacioni ekzistues duhet të përmirësohet për të siguruar ruajtjen e të gjitha habitateve kritike të Pelikanit kacurrel në Shqipëri. Palët përgjegjëse dhe ato të interesuara duhet të sigurojnë zbatimin e tij të plotë. Trainimi i stafit të ARZM-s dha aktorëve të tjerë në terren në lidhje me zbatimin e ligjit është i domosdoshëm.

**Aktivitete:**

a. Vendosje e rojeve për të mundësuar një regjim të rreptë kontrolli mbi vendndodhjen e zonës së folezimit në Divjakë-Karavasta për periudhën Janar-Korrik të cdo viti. Rojet nuk duhet të lejojnë hyrjen e turisteve, peshkatareve dhe vizitorëve të tjerë brenda zonës së shënuar me bova. Ky ndalim përjashton vizitat për qëllime strikt studimore, të autorizuara nga Autoritetet e Parkut dhe autoritetet kombëtare përgjegjëse për menaxhimin dhe ruajtjen e biodiversitetit.

b. Kontroll i shtuar i aksesit te njeriut në zonat me rëndësi për Pelikanin kacurrel në Shqipëri e sidomos në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parkun Kombëtar të Prespës, veçanërisht në Liqenin e Prespës së Vogël, Liqenin e Shkodrës, Rezervuarin e Thanës, Kune-Vain dhe kompleksin lagunor të Nartës me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për pelikanët dhe llojet e tjera të shpendëve.

c. Ndalim i prerjeve/djegieve të kallamishteve në zonat kyçe: Liqeni i Shkodrës (në anën verilindore), Kune-Vain (delta e Drinit) dhe Liqenin e Prespës së Vogël.

***Prioriteti:*** *Thelbësor*

***Përgjegjësia***: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM); Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM) të Fierit, Korçës, Lezhës, Shkodrës, Beratit and Vlorës; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MoE).

***Palët e tjera të interesura***: Ministria e Mjedisit, Bashkitë e Divjakës, Pustecit, Lezhës, Shkodrës, Lushnjes, Kucovës dhe Vlorës, institucionet lokale, ndërmarrjet e peshkimit apo komuniteti i peshkatarëve në zonë, organizatat lokale, insitucionet shkencore etj.

***Kohëveprimi***: I menjëhershëm dhe në vazhdim.

**A.2. Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në ligatina**

Duhet të promovohet një qasje e integruar për ruajtjen e ligatinave nga ku do të përfitojë ruajtja e llojeve të tjera. Një qasje e tillë do të mbrojë zonat nga zhvillimi i paqëndrueshëm shoqëruar me ndotje, degradim dhe humbje të habitateve. Njëkohësisht do të rrisë të ardhurat për komunitetet lokale. Përfshirja e tyre në ruajtjen dhe menaxhimin e species dhe të habitateve kritike është e rëndësie së vecantë.

***Aktivitete:***

a. Promovimi i konceptit të zonimit, miratuar tashmë përmes Planeve të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parkut Kombëtar të Prespës ku zona kufitare e Shqipërisë është përcaktuar si "Zonë ku ndalohet gjuetia e peshkut", Rezervës Natyrore të Menaxhuar të Shkodrës, Kune-Vainit, Patokut dhe Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë.
b. Promovim i ruajtjes dhe përfitimit të ndërsjellë me peshkatarët lokalë në Divjakë-Karavasta dhe Liqenin e Prespës së Vogël për rimëkëmbjen e kolonive folezuese të Pelikanit aty ku përshtatshmëria e habitateve e lejon atë.
c. Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.
d. Lobim kundër instalimit të infrastrukturës së shpimit të naftës në lagunën e Nartës me qëllimin e ruajtjes së habitatit dhe specieve.

***Prioriteti:*** *Thelbësor*

***Përgjegjësia***: AKZM (AKZM); ARZM-të e Fierit, Korçës, Lezhës, Shkodrës and Vlorës; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MoE).

***Palët e tjera të interesura***: Ministria e Mjedisit, Bashkitë e Divjakës, Pustecit, Lezhës, Shkodrës dhe Vlorës, institucionet lokale, organizatat lokale dhe shoqëria civile, etj.

***Kohëveprimi***: I menjëhershëm dhe në vazhdim

**A.3. Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar**

Pelikanët ndajnë habitate ndërkufitare ose shtegtojnë në vende të ndryshme ndaj edhe studimet dhe veprimet e ruajtjes së tyre duhet të koordinohen me të gjitha autoritetet përgjegjëse në vendet ku strehohen Pelikanët kacurrel folezues apo i pranishëm në Shqipëri.

***Aktivitete***:

a. Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit në vendet fqinje si Greqia, Mali i Zi dhe Maqedonia nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara.
   - Greqi (Prespa e Vogël, Prespa e Madhe, Amvrakikos)
   - Mali i Zi (Liqeni i Shkodrës, Kriporet e Ulqinit)
   - Maqedoni (Prespa e Madhe)
b. Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të të katër vendeve në mbrojtje të biodiversitetit të ligatinave kyçe, veçanërisht në vendet trans-kufitare.
c. Promovim i punës së përbashkët ekipore, hartimin dhe zbatimin e protokolleve të përbashkët të grumbullimit të të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit.
d. Përmirësim i bashkëpunimit mes OJF-ve nga të katër vendet.

***Prioriteti***: I mesëm

***Përgjegjësia***: Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MoE). AKZM; Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM) e Fierit, Korçës, Shkodrës and Vlorës;

***Palët e tjera të interesura***: Ministria e Mjedisit, Bashkitë e Divjakës, Pustecit, Shkodrës dhe Vlorës, institucionet lokale, organizatat lokale, institucionet shkencore etj..

***Kohëveprimi***: I mesëm dhe në vazhdim

**A.4. Studim i aspekteve socio-ekologjike dhe pëdorimi i analizave kosto-përfitim në procesin e vendimmarrjes**

Pelikani kacurrel ka qenë në të shkuarën subjekt i dëmtimeve të qëllimshme nga sektori i peshkimit duke qenë se konsiderohej konkurrent për aktivitetin e peshkimit. Ky konflikt është reduktuar tashmë ndjeshëm por studimi i aspekteve të tjera të mundshme të konfliktualitetit mbetet ende i rëndësishëm.

Ndërkaq, Pelikani ka padyshim vlera ekonomike që lidhen kryesisht me pamjen e tij dhe faktin që sot konsiderohet gjerësisht si symbol i ekoturizmit në Divjakë-Karavasta.

***Aktivitete:***

a. Ndërmarrja e studimeve socio-ekologjike në zonat kyçe të Pelikanit Kaçurrel, me qëllim identifikimin e konflikteve ekzistuese ose të mundshme mes njerëzve dhe pelikanëve.
b. Ndërmarrja e një analizë kosto-përfitim për të identifikuar dhe për të promovuar përfitimet ekonomike që rrjedhin nga ruajtjen e Pelikanit kaçurrel.

c. Realizimi i një studimi mbi shërbimet që ofron ekosistemi për të identifikuar vleren e saktë dhe të ardhurat dhe metoden e përshtatshme.

***Prioriteti***: I mesëm

***Përgjegjësia:*** ARZM-të e Fierit, Vlores, Beratit, Shkodres dhe Lezhes, institucionet përgjegjëse shkencore, shoqëria civile.

***Palët e tjera të interesura***: Ministria e Mjedisit, AKZM, Pushteti Vendor insitucionet lokale, shoqatat e gjuetarëve etj.

***Kohëveprimi***: I mesëm

## B. Menaxhim dhe ruajtje e habitateve

### B.1. Stabilizim i habitateve të folezimit, të fjetoreve dhe vendeve të qëndrimit

Erozioni historik i shkaktuar nga valët, rrymat ujore dhe zhvillimet në bregdet ka rritur shkallën e erozionit të vendeve të folezimit, të fjetoreve apo vendeve të qëndrimit të Pelikani kacurrel në Karavasta por edhe zona të tjera. Prej këtu lind nevoja për ndërhyrje në dobi të stabilizimit të ishujve të folezimit, sidomos në Lagunën e Karavastasë ku nga tre ishuj të përdorur dikur për folezim sot mbetet vetëm një i tillë. Aktivitetet në terren për stabilizimin e ishujve mund të amortizojnë energjinë e valëve dhe të minimizojnë dëmet e shkaktuara nga ngjarjet ekstreme të motit dhe rritja e nivelit të ujërave.

***Aktivitete:***

a. Kryerja e studimit ndërdisiplinor për projektimin teknik të strukturave të stabilizimit dhe instalimeve përfshirë modelimin e efektit të valëve dhe rrymave në erodimin e ishujve të folezimit.

b. Zbatimi i skemës pilot të stabilizimit në lagunën e Karavastasë.

***Prioriteti:*** I mesëm

***Përgjegjësia***: AKZM (AKZM); Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura (ARZM) e Fierit; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MoE).

***Palët e tjera të interesura***: Ministria e Mjedisit, insitucionet lokale, organizatat lokale, institucionet shkencore, etj.

***Kohëveprimi***: I mesem dhe në vazhdim.

**B.2. Nxitje e folezimit nëpërmjet përdorimit të strukturave artificilale**

Bëhet fjalë për ndihmesën e kolonisë ekzistuese dhe atyre të pritshme me struktura (platforma) apo materiale artificiale. Ndërtimi i platformave ka rezultuar i suksesshëm në plot raste në rajon. Ndërsa përdorimi i mjeteve artificiale i ka ardhur shumë në ndihmë kolonisë së Pelikanit kacurrel në Karavasta e sidomos gjatë viteve 2015 dhe 2016. Administrata e zonës së mbrojtur, e mbështetur nga organizata lokale, ka dërguar në ishull degë pishash, shkarpa si dhe degëza të kripthit (Salicornia sp.) që më pas janë përdorur nga pelikanët si struktura apo materiale folezimi. Përdorimi i tyre ka ndihmuar së tepërmi në reduktimin e dëmeve te mundshme nga përmbytjet.

***Aktivitete***:

a. Furnizim me degë, shkarpa dhe kripth i ishullit të folezimit ne Divjakë-Karavasta në periudhën 15 Nëntor- 15 Dhjetor të cdo viti.
b. Kur është e përshtatshme dhe në zonat plotësisht të mbrojtura të tilla si Shkodra dhe Prespa e Vogël, të sigurojë struktura të përshtatshme artificiale (platforma) ose materiale për të lehtësuar riprodhimin ose qëndrimin.

***Prioriteti:*** Thelbësor

***Përgjegjësia***: Ministria e Mjedisit, AKZM, ARZM-te Fier, Shkodër dhe Korcë, shoqata mjedisore.

***Palët e interesuara***: Ministria e Mjedisit, Drejtoria e Peshkimit (Ministria e Bujqësisë), Ndërmarrjet lokale të peshkimit, institucionet lokale, shoqatat lokale, shoqatat e gjuetarëve, Institucionet shkencore, etj.

***Kohëveprimi***: I menjëhershëm dhe në vijim

**B.3. Zbutje dhe ndalim i eutrofikimit dhe efekteve të tij**

Cilësia e mirë e habitateve ushqyese për Pelikanin kacurrel varet nga hyrja dhe dalja e rregullt e ujit në lagunë. Me këtë lidhet dhe normalizimi i kripësisë, oksigjenit të tretur në ujë etj. Kjo do të shmangte dhe krizat e mundshme distrofike që kanë qenë subjekt i shpeshtë në të kaluarën e sidomos në Nartë, dhe Karavasta.

Për më tepër, futja dhe përhapja e bimësisë invazive po degradon më tej habitatin dhe rënien e popullsisë për shumë lloje indikatore bimore dhe sidomos per ichtiofaunën që përbën dhe bazën ushqimore të Pelikanit kacurrel. Zhvillimi i rasteve bregdetare si *Ficopomatus enigmaticus*, mund të çojë në kolaps total të cektinave ligatinore, përhapjen e llojeve ekzotike dhe mbizotërimin e bimëve të huaja mbi bimësisë vendase.

Në mënyrë që të sigurojë ushqim të përshtatshëm dhe habitate shumimi, rehabilitimi është i nevojshëm për të mbështetur (a) fluksin e rregullt të ujit në hyrje dhe dalje dhe (ii) bimësinë vendase dhe kufizimin e rritjes dhe përhapjes të llojeve të huaja.

**Aktivitete:**

a. Kontrolli/Harmonizimi i skemës së ujit në hyrje dhe dalje në kanalet e komunikimit në lagunën Karavastasë (si detare dhe kontinentale)

b. Kryerja e studimeve për vlerësimin e gjendjes ekologjike të trupave ujorë dhe burimet e ndotjes që ndikojnë në integritetin e ekosistemeve ujore

c. Bashkëpunimi me autoritetet qeveritare për ngritjen e sistemeve të trajtimit të ujërave të zeza dhe të bardha

***Prioriteti***: I mesëm

***Përgjegjësia***: AKZM (AKZM); ARZM-të (ARZM) të Fierit, Korçës, Shkodrës dhe Vlorës; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MoE).

***Palët e tjera të interesura***: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, institucionet lokale, Organizatat e menaxhimit të peshkimit (OMP), institucionet shkencore, Ministria e Bujqësisë, Këshilli Kombëtar i Ujërave.

***Kohëveprimi***: I mesëm

### C. Monitorim i efektivave të Pelikanit kacurrel në Shqipëri dhe habitateve kritike të tij

#### C.1. Monitorim i pelikanëve riprodhues, dimërues apo të përhershëm

Monitorimi është i nevojshëm për të vlerësuar madhësinë aktuale të kolonisë dhe suksesin e tyre në shumim. Kjo do të masë tendencën e kolonisë dhe do të vlerësojë suksesin e masave të ruajtjes të ndërmarra.

Shkalla e mbijetesës së llojeve varet shumë nga faktorët që ndodhin në vendet e dimërimin të pelikanit Kaçurrel. Për pasojë, monitorimi i shpendëve dimërues dhe zonat e tyre të qëndrimit në zonat e dimërimit është shumë i nevojshëm për konservimin e suksesshëm të llojeve.

Përvec sa më sipër monitorimi në një koloni me numër të reduktuar, sikurse ajo e Divjakë-Karavastasë duhe të përfshijë dhe rastet e sëmundjeve dhe ngordhjeve, të cilat ndonëse te pakta duhen studiuar për shkak të impaktit të mundshëm në koloninë riprodhuese.

***Aktivitete:*** MINISTRIA E MJEDISIT

a. Monitorim i përvitshëm i evolucionit të numrit të çifteve riprodhuese dhe suksesit të riprodhimit të kolonisë ekzistuese dhe kolonive të tjera të mundshme.

   Monitorimi mund të përfshijë maksimalisht dy vizita në ishullin e folezimit gjatë kohës së riprodhimit por pa vendosur në rrezik shpendët e rritur, të vegjlit, vezët dhe pa ndikuar suksesin e riprodhimit të kolonisë. Vizita e parë duhet të kryhet në fund të javës së tretë të kolonizimit për të patur një ide të saktë të numrit të cifteve riprodhues dhe të vetë suksesit të riprodhimit. Vizita e dytë duhet të kryhet në fund të sezonit të folezimit për një evidentim tqë të plotë të numrit te foleve, suksesit të riprodhimit, vdekjeve të mundshme etj. Gjithë vizitat e tjera gjatë sezonit te riprodhimit duhet të kryhen në distance, me qëllim shmangien dhe reduktimin maksimal te shqetësimit të shpendëve folezues.

b. Monitorimi i Pelikanëve dimërues, mundësisht në zonat e fjetjes apo të qëndrimit në secilën IBA (Zonë e Rëndësishme për Shpendët). Monitorimi duhet përsëritur tre herë: fillim dhe fund të muajit Dhjetor dhe mesi i muajit Janar.

c. Monitorimi i pelikanëve të sëmurë apo të ngordhur dhe identifikimi i shkaqeve të ngordhjes.

d. Matja e përqëndrimit të pesticideve dhe metaleve të rënda tek vezët e Pelikanëve

e. Ngritje e një qendre rehabilitimi për individët e sëmurë të Pelikanit kacurrel në Divjakë-Karavasta.

***Prioriteti:*** Thelbësor

***Përgjegjësia***: ARZM-të, Institucionet përgjegjëse shkencore, OJF të specializuara në mbrojtjen e shpendëve.

***Palët e tjera të interesura***: Ministria e Mjedisit, AKZM, institucionet lokale, shoqëria civile, institucionet shkencore etj.

***Kohëveprimi:*** I menjëhershëm dhe në vazhdim

**C.2. Monitorim i cilësisë së habitatit jetik për Pelikanin kacurrel**

Monitorimi i cilësisë së habitatit duhet të marrë në konsideratë parametrat jo-biologjike dhe biologjike dhe do të mundësojë vlerësimin e cilësisë së sasisë së ujit dhe më tej të ndihmojë dhe këshillojë aty ku cilësia e ujit është e dobët, me qëllim përmirësimin e kushteve për Pelikanin kaçurrel.

Monitorimi duhet të mbështetet nga të dhënat aktuale statistikore të ofruara nga sektori i peshkimit të cilat, për arsye të ndryshme, kanë mangësi serioze. Megjithatë, përfshirja e peshkimit në praktikat e zakonshme të monitorimit (qasjet sipas Direktivës Evropiane për Ujin) do ta mbushë këtë boshllëk.

***Aktivitete***:

a. Monitorimin periodik (të paktën një herë në tre muaj) i cilësisë së ujit ne Divjakë-Karavasta nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit në përputhje me Direktivën Evropiane të Ujit. Monitorimi përfshin variablat e integruar biologjike dhe jo-biologjike përfshië metalet e rënda.
b. Monitorimi i kapjes së peshkut në zonat kyç të Pelikanit kaçurrel (Karavasta, Nartë, Shkodër, Kune-Vain, Patok, Thanë, Butrinti etj) nëpërmjet një programi specific të monitorimit dhe në bashkëpunim me shërbimet zyrtare përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave.
c. Monitorim i cilësisë së habitateve ujore nëpërmjet bioindikatorëve si Lundërza (Lutra lutra) etj.

***Prioriteti:*** I mesëm

***Përgjegjësia***: AKZM, ARZM-të e Fierit, Korçës, Shkodrës and Vlorës; Drejtoria e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura (MoE).

***Palët e tjera të interesura***: Ministria e Mjedisit, Ministria e Bujqësisë, ndërmarrjet lokale të peshkimit, insitucionet lokale, shoqëria civile, institucionet shkencore etj.

***Kohëveprimi***: I mesëm dhe në vazhdim

## D. Edukim dhe Trainim

### D.1. Edukim dhe rritje e ndërgjegjesimit të publikut

Edukimi dhe ndërgjegjësimi mjedisor i ndërmarrë në 20 vitet e fundit duket se po jep frytet e veta por ka ende nevojë që ruajtja e Pelikanit kacurrel të rrënjoset jo vetëm në komunitetin vendor por edhe atë kombëtar.

**Aktivitete:**

a. Informimi i gjerë i përdoruesëve të burimeve ujore, grupeve të ndryshme të interesit në nivel lokal dhe ndërkombëtar mbi rëndësinë e rujajtjes dhe përmirësimet e nevojshme për Pelikanin kaçurrel.
b. Organizmi i fushatave ndërgjegjësuese publike me gjuetarët, peshkatarët, komunitetet lokale, operatorët turistikë, institucionet qeveritare që janë pjesë e mbrojtjes së Pelikanit kacurrel.
c. Përgatitja e publikimeve si (fletpalosje, broshura, postera, etj.) mbi rëndësinë e zonave në kontekstin kombëtar dhe ndërkombetar.
d. Përgatitja e një filmi dokumentar mbi situatën aktuale të Pelikanit Kaçurrel dhe nevojës për përmirësim.

***Prioriteti***: I mesëm

***Përgjegjësi***: AKZM, Drejtoria e Biodiversitetit (Ministria e Mjedisit)

***Palët e tjera të interesura***: Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit dhe komuniteti i peshkatarëve, Ministria e Arsimit, Institucionet lokale, OJF lokale.

***Kohëveprimi:*** I mesëm dhe në vazhdim

**D.2. Trainim i mëtejshëm i stafit të ARZM-ve përgjegjëse, administrates vendore dhe grupeve të tjera të interesit**

Menaxhimi i mirë i popullatës së Pelikanit kacurrel ka nevojë për staf administrativ me kapacitetet e duhura teknike dhe njohuritë e nevojshme për administrimin e faunës dhe të habitateve kritike. Në këto kushte është e nevojshëm trainimi në vazhdimësi i stafit dhe i palëve të interest.

**Aktivitete**

a. Trainim i stafit të ARZM-ve në lidhje me edukimin mjedisor, ruajtjen dhe menaxhimin e shpendëve, jetës së egër në përgjithësi dhe ligatinat.

b. Trainimi i OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit për ruajtjen e natyrës duke u përqëndruar veçanërisht në ruajtjen e Pelikanit kacurrel.

c. Zhvillimi i një moduli trainimi për stafin ARZM-s përgjegjës për zbatimin e ligjit mbi rregullat dhe rregulloret që lidhen me mbrojtjen e Pelikanit Kaçurrel.

d. Rritja e kapaciteteve teknike të punonjësve të zonave të mbrojtura mbi:

   - monitorimin e shpendëve.
   - Pajisjet e menaxhimit të cilat janë të rëndësishme për ruajtjen e Pelikanit Kaçurrel
   - Kontrollin e grabitqarëve
   - Minimizimin e ndërhyrjeve nga njerëzit dhe shqetësimeve të tjera të veçanta
   - Stabilizimin e aktiviteteve bregdetare.

e. Përgatitja e programeve specifike të trainimit për anëtarët e OMP-ve mbi rritjen e kapaciteteve në menaxhimin

***Prioriteti***: I mesëm

***Pergjegjësi***: AKZM, ARZM-të e Fierit, Korçës, Lezhës, Shkodrës dhe Vlorës

***Palët e tjera të interesuara***: Ministria e Mjedisit, OMP-të, Ministria e Arsimit, Bashkia Divjakë, Pustec, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë, Institucionet lokale, OJF-të lokale etj.

***Kohëveprimi:*** I mesëm

**E. Nxitje e aktiviteteve të qëndrueshme të turizmit natyror**

Turizmi natyror është një mundësi ekonomike në rritje për një numër të madh të zonave të mbrojtura e sidomos të atyre qe strehojnë Pelikanin kacurrel. Këtë e vërteton numri në rritje i vizitorëve të specializuar përfshirë profesionistë apo amatorë të apasionuar pas natyrës dhe elementeve të biodiversitetit ku futen kryesisht shpendët, lulet, fluturat etj.

Por ky interes në rritje duhet menaxhuar në mënyrën më të mirë për të qenë jo vetëm i kontrolluar por edhe që ti shërbejë më së miri administrimit të Zonave të Mbrojtura apo Llojeve të vecanta.

***Aktivitete***:

a. Organizimi i trainimeve mbi guidat turistike dhe sigurimi me informacion të nevojshëm mbi edukimin mjedisor.
b. Sigurimi i tureve të organizuara nga të paktën 10 operatorë turistik të specializuar në turizmin e botës së egër.
c. Hartimi dhe botimi i një manuali "Si të sillemi në zonat ku jeton Pelikani Kaçurrel"

***Prioriteti***: I mesëm

***Përgjegjësi***: AKZM, Ministria e Mjedisit

***Palët e tjera të interesura***: Ministria përgjegjëse për turizmin, OMP-të, Ministria e Arsimit, institucionet lokale, OJF-të lokale.

***Kohëveprimi:*** I mesëm

**F.1. Bashkëpunim i Administratës së Zonave të Mbrojtura me organizatat partnere**

Stafi i zonave të mbrojtura duhet të vazhdojë të bashkëpunojë me : (i) Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit; (ii) Operatoret turistikë rajonalë apo kombëtar; (iii) Autoritetet vendore; (iv) Muzeun e Shkencave Natyrore; (v) Zyrat Rajonale të Bujqësisë - Sesioni i Veterinarisë dhe (vi) Organizatat jo Fitimprurëse të specializuara për të mbledhur të dhëna mbi pelikanin duke përfshire dëmtimet dhe vdekshmërinë. Ky bashkëpunim do të lehtësonte shpërndarjen e informacionit mbi aspekte të ndryshme si: dëmtimet nga aktiviteti njerëzor dhe situatave rastësore të vdekshmërisë nga eventet e ndryshme.

Shpërndarja e informacionit do të ndihmoje stafin e zonave të mbrojtura dhe biologët për të kuptuar më mirë trendin dhe kërkesat për ruatje.

***Aktivitete :***

a. Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e Pelikanit kacurrel për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet.
b. Bashkëpunimi me shërbimin e veterinarisë duhet që të mbahet në mënyrë efektive për të siguruar një përgjigje në kohë mbi çdo rast për rehabilitimin e shpendëve dhe klinikat duhet të inkurajohen që të raportojne rastet e sëmundjeve të shpendëve.

***Prioriteti***: Thelbësor

***Përgjegjesi***: AKZM; ARZM-të Fier, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë

***Palët e tjera të interesuara***: Ministria e Mjedisit, institucionet shkencore, OJF të specializuara etj.

***Kohëveprimi***: I menjëhershëm

## 8. Kushtet paraprake për zbatim të planit

Zbatimi i këtij plani kërkon domosdoshmërisht ruajtjen ne gjendjen ekzistuese të habitateve kritike të Pelikanit kacurrel në Shqipëri. Kjo do te thotë ndalim të planeve të mundshme për tjetërsimin të habitateve jetike në zonat qendrore të Zonave të Mbrojtura dhe kthimin e tyre në troje ndërtimi, zona për nxjerrjen e naftës apo zona për zhvillimin e turizmit masiv. Gjithashtu, kusht tjetër thelbesor është pjesëmarrja aktive e të gjithë grupeve të interest. Kjo e fundit do të garantonte zbatimin me sukses të të gjitha aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit.

## 9. Problemet e pritshme gjatë implementimit

Zbatimi i planit mund te shbëhet nëse ka tjetërsim të habitatit per zhvillime turistike, për nxjerrje të hidrokarbureve apo për aktivitete të turizmit masiv që përkeqësojnë cilësinë dhe gjendjen e habitatit jetike, zonave qendrore të Zonave të Mbrojtura dhe të llojeve bimore apo shtazore.

Gjithashtu, sikurse dhe plane të tjera të mbështetura në ekologjinë e aplikuar, plani ka disa rreziqe që janë të lidhura me katastrofat ekologjike natyrore apo me aktivitetin njerëzor të pakontrolluar të shfaqur në formën e shqetësimit të papritur të kolonisë.

### 9.1. Katastrofat Ekologjike Natyrore

- Kushtet e ashpra të motit (mot me stuhi, shi i fortë, erë e fortë, temperatura shumë të larta ose të ulta, përmbytje të zonave të folezimit, etj.)
- Epidemitë ose sëmundje të shpendëve

### 9.2. Impakti njerëzor

Është tashmë e njohur që faktori njerëzor i shprehur si shqetësimi njerëzor influencon fortësisht komunitetin e shpendëve në Shqipëri. Nëse gjuetia nuk kontrollohet, shpendët e persekutuar do të largohen nga Karavastaja për të gjetur vende më të qeta. Nëse kolonitë vizitohen ose keqtrajtohen nga njerëzit atehere numri i riprodhimit të shpendëve do të zvogëlohet, suksesi i riprodhimit do të jetë shume i ulët dhe në terma afatgjatë rezultati do të jetë një reduktim i numrit të Pelikanit kaçurrel në Shqipëri.

Njëkohësisht ndikimi i faktorit njerëzor është një nga më të vështirët për t'u matur e kontrolluar. Mënyra e vetme në terma afatshkurtër për të parandaluar impaktin negativ është mbrojtja e vëndeve të riprodhimit nëpërmjet rojeve. Metoda afatgjatë është të rritet ndërgjegjësimi i publikut për të krijuar bindjen se Pelikani Kacurrel është një vlerë mjaft të rëndësishme ekonomike për zhvillimin e ekonomisë lokale.

## 10. Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese

Aktivitetet për ruajtjen e llojit shtrihen gjatë gjithë kohës së zbatimit të planit, pra në periudhën kohore 2016-2021. Por, aktivitetet të cilësuara si thelbësore dhe me efekt të menjëhershëm janë parashikuar të zbatohen që në vitin e parë të planit. Ndërkaq, aktivitetet e tjera do të zbatohen në vitet në vijim (Tab.1).

**Tabela 1. Shtrirja në kohë e aktiviteteve konservuese**

| Nr. | Aktivitetet | Periudha |
|---|---|---|
| | **Mbështetje për administratën zbatuese dhe OJF-të lokale**<br>- Kompjuter dhe softëare<br>- GPS<br>- Pajisje te tjera terreni<br>- Mjete transporti (varka dhe motocikleta) | Viti 1-2 |
| A | **Përmirësim i politikave dhe legjislacionit** | |
| A.1. | **Përmirësim i ligjit dhe zbatim i plotë i tij** | |
| A.1.a. | Kontroll strikt i zonës së folezimit në lagunën e Karavastasë | Muaji Janar-Korrik për cdo vit |

| | | |
|---|---|---|
| A.1.b. | Kontroll i shtuar i aksesit te njeriut në zonat me rëndësi për Pelikanin kacurrel në Shqipëri e sidomos në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parkun Kombëtar të Prespës, veçanërisht në Liqenin e Prespës së Vogël, Liqenin e Shkodrës, Rezervuarin e Thanës, Kune-Vain dhe kompleksin lagunor të Nartës me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për pelikanët dhe llojet e tjera të shpendëve. | Gjatë gjithë kohës |
| A.1.c. | Ndalim i prerjes/djegies së kallamishteve në zonat kyçe të shpërndarjes së Pelikanit kacurrel (ana verilindore e Liqenit të Shkodrës, Kune-Vain dhe Liqenin e Prespës së Vogël.) | Gjatë gjithë kohës |
| **A.2.** | **Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në ligatina** | |
| A.2.a. | Promovimi i konceptit të zonimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parkut Kombëtar të Prespës, Rezervës Natyrore të Menaxhuar të Shkodrës, Kune-Vainit, Patokut dhe Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë. | Gjatë gjithë kohës |
| A.2.b. | Promovim i ruajtjes dhe përfitimit të ndërsjellë me peshkatarët lokalë në Divjakë-Karavasta dhe Liqenin e Prespës së Vogël për rimëkëmbjen e kolonive folezuese të Pelikanit kacurrel. | Gjatë gjithë kohës |
| A.2.c. | Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. | Viti i I-rë |
| A.2.d. | Lobim kundër instalimit të infrastrukturës së shpimit të naftës në lagunën e Nartës me qëllimin e ruajtjes së habitatit dhe specieve. | Viti i I-rë |
| **A.3.** | **Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar** | |
| A.3.a. | Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit të Greqisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara. | Viti I-rë e në vazhdim |
| A.3.b. | Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të të katër vendeve në mbrojtje të biodiversitetit të ligatinave kyçe, veçanërisht në vendet trans-kufitare | Viti I-rë e në vazhdim |
| A.3.c. | Promovimi i punës së përbashkët dhe shkëmbim të informacionit | Viti II-të e në vazhdim |
| A.3.d. | Përmirësimi i bashkëpunimit mes OJQ-ve nga të katër vendet (Shqipëri, Mal i Zi, Maqedoni dhe Greqi) | Viti I-rë e në vazhdim |
| **A.4.** | **Studim i aspekteve socio-ekologjike dhe pëdorimi i analizave kosto-përfitim në procesin e vendimmarrjes** | |

| | | |
|---|---|---|
| A.4.a. | Ndërmarrja e studimeve socio-ekologjike në zonat e rëndësishme të Pelikanit kaçurrel, në mënyrë që të identifikohen konfiktet ekzistuese ose të mundshme midis njerëzve dhe pelikanëve | Viti 2-3 |
| A.4.b. | Ndërmarrja e një analize kosto-përfitim me qëllim identifikimin dhe promovimin e përfitimeve ekonomike që burojnë nga mbrojtja e Pelikanit kacurrel | Viti 3-4 |
| A.4.c. | Realizimi i një studimi mbi shërbimet që ofron ekosistemi për të identifikuar vleren e saktë dhe të ardhurat dhe metoden e përshtatshme | Viti 3-4 |
| **B.** | **Menaxhim dhe ruajtje e habitateve** | |
| **B.1.** | **Stabilizim i habitateve të folezimit, të fjetoreve dhe vendeve të qëndrimit** | |
| B.1.a. | Kryerja e studimit ndërdisiplinor për projektimin teknik të strukturave të stabilizimit dhe instalimeve përfshirë modelimin e efektit të valëve dhe rrymave në erodimin e ishujve të folezimit. | Viti 2-3 |
| B.1.b. | Zbatimi i skemës pilot të stabilizimit në lagunën e Karavastasë. | Viti 3-4 |
| **B.2.** | **Nxitje e folezimit nëpërmjet përdorimit të strukturave artificilale** | |
| B.2.a. | Furnizm i me degë, shkarpa dhe kripth i ishullit të folezimit ne Divjakë-Karavasta. | 15 Nëntor- 15 Dhjetor të cdo viti |
| B.2.b. | Sigurim i strukturave të përshtatshme artificiale ose materiale për të lehtësuar riprodhimin ose qëndrimin (në Shkodër, Prespë e Vogël, Kune-Vain) në varësi të nevojës dhe mundësive për riprodhim të Pelikanëve | Viti 2-4 |
| **B.3.** | **Zbutje dhe ndalim i eutrofikimit dhe efekteve të tij** | |
| B.3.a. | Kontrolli/Harmonizimi i skemës së ujit në hyrje dhe dalje në kanalet e komunikimit në lagunën Karavastasë (si detare dhe kontinentale) | Viti 2-5 |
| B.3.b. | Kryerja e studimeve për vlerësimin e gjendjes ekologjike të trupave ujorë dhe burimet e ndotjes që ndikojnë në integritetin e ekosistemeve ujore | Viti 2-4 |
| B.3.c. | Bashkëpunim i strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura me autoritetet qeveritare për të arritur vendosjen e një sistemi të integruar të trajtimit të ujërave të zeza dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta | Viti 2-4 |
| **C.** | **Monitorim i efektivave të Pelikanit kacurrel në Shqipëri dhe habitateve kritike të tij** | |
| **C.1.** | **Monitorim i Pelikanëve riprodhues, dimërues apo të përhershëm** | |

| | | |
|---|---|---|
| C.1.a. | Monitorim i përvitshëm i evolucionit të numrit të çifteve riprodhuese dhe suksesit të riprodhimit të kolonisë ekzistuese dhe kolonive të tjera të mundshme. | Janar-Korrik i cdo viti |
| C.1.b. | Monitorim i Pelikanëve dimërues, mundësisht në zonat e fjetjes apo të qëndrimit në secilën IBA | Fillim Dhjetor, fund Dhjetor dhe mes Janar |
| C.1.c. | Monitorim i Pelikanëve të sëmurë apo të ngordhur dhe identifikimi i shkaqeve të ngordhjes. | Gjatë gjithë kohës |
| C.1.d. | Matja e përqëndrimit të pesticideve dhe metaleve të rënda tek vezët e Pelikanëve | Viti 2-5 |
| C.1.e. | Ngritje e një qendre rehabilitimi për individët e sëmurë të Pelikanit kacurrel në Divjakë-Karavasta. | Viti 2-3 |
| **C.2.** | **Monitorim i cilësisë së habitatit jetik për Pelikanin kacurrel** | |
| C.2.a. | Monitorimin periodik i cilësisë së ujit nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit në përputhje me Direktivën Evropiane të Ujit | Cdo trimestër - Viti 1-5 |
| C.2.b. | Monitorimi i kapjes së peshkut në zonat kyç të Pelikanit kaçurrel (Karavasta, Nartë, Shkodër, Kune-Vain, Patok, Thanë, Butrinti etj). | Viti 2-5 |
| C.2.c. | Monitorim i cilësisë së habitateve ujore nëpërmjet bioindikatorëve si Lundërza (Lutra lutra) etj. | Viti 2-5 |
| **D.** | **Edukim dhe Trainim** | |
| **D.1.** | **Edukim dhe rritje e ndërgjegjesimit të publikut** | |
| D.1.a. | Informimi i gjerë i përdoruesve të burimeve ujore, grupeve të interesit në nivel lokal dhe kombëtar, rreth rëndësisë së ruajtjes dhe rimëkëmbjes së Pelikanit kacurrel | Viti 3-5 |
| D.1.b. | Organizmi i fushatave ndërgjegjësuese publike me gjuetarët, peshkatarët, komunitetet lokale, operatorët turistikë, institucionet qeveritare që janë pjesë e mbrojtjes së Pelikanit kacurrel | Viti 3-5 |
| D.1.c. | Përgatitja e publikimeve (fletpalosje, broshurave, posterave, etj.) rreth rëndësisë kombëtare dhe ndërkombëtare të zonave të shpërndarjes se Pelikanit kacurrel | Viti 2-5 |
| D.1.d. | Përgatitja e një filmi dokumentar rreth situatës aktuale të Pelikanit kaçurrel dhe nevojës për përmirësim | Viti 2-3 |

| | | |
|---|---|---|
| **D.2.** | **Trainim i mëtejshëm i stafit të ARZM-ve përgjegjëse, administrates vendore dhe grupeve të tjera të interest** | |
| D.2.a. | Trainim i stafit të ARZM-ve në lidhje me edukimin mjedisor, ruajtjen dhe menaxhimin e shpendëve, jetës së egër në përgjithësi dhe ligatinat | Viti 2-4 |
| D.2.b. | Trainimi i OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit për ruajtjen e natyrës duke u përqëndruar veçanërisht në ruajtjen e Pelikanit kacurrel | Viti 2-4 |
| D.2.c. | Zhvillimi i një moduli trainimi për stafin ARZM-s përgjegjës për zbatimin e ligjit mbi rregullat dhe rregulloret që lidhen me mbrojtjen e Pelikanit Kaçurrel. | Viti 2-3 |
| D.2.d. | Rritja e kapaciteteve teknike të punonjësve të zonave të mbrojtura mbi monitorimin e shpendëve, pajisjet e menaxhimit të rëndësishme për ruajtjen e Pelikanit kaçurrel, kontrollin e grabitqarëve, minimizimin e ndërhyrjeve nga njerëzit dhe shqetësimeve të tjera të veçanta dhe stabilizimin e aktiviteteve bregdetare. | Viti 2-3 |
| D.2.e. | Përgatitja e programeve specifike të trainimit për anëtarët e OMP-ve mbi rritjen e kapaciteteve në menaxhimin | Viti 2-5 |
| **E.** | **Nxitje e aktiviteteve të qëndrueshme të turizmit natyror** | |
| E.1.a. | Organizimi i trainimit të guidave natyrore dhe sigurimi me informacionin të nevojshëm për edukimin mjedisor | Viti 2-4 |
| E.1.b. | Sigurimi i tureve të organizuara nga të paktën 10 operatorë turistik të specializuar në turizmin e botës së egër | Viti 2-5 |
| E.1.c. | Hartimi dhe botimi i një manuali “Si të sillemi në zonat ku jeton Pelikani kaçurrel” | Viti 2-3 |
| **F.** | **Bashkëpunim i Administratës së Zonave të Mbrojtura me organizatat partnere** | |
| F.1.a. | Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e Pelikanit kacurrel për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet. | Viti 2-5 |
| F.1.b. | Bashkëpunimi efektiv me shërbimin e veterinarisë për të siguruar një përgjigje në kohë mbi identifikimin e sëmundjeve dhe rehabilitimin e shpendëve. | Viti 2-5 |

### 11. Monitorimi i Planit të Veprimit

Çdo projekt ka nevojë për monitorim të thellë në mënyrë që suksesi i Planit të Veprimit të bëhet i matshëm. Monitorimi duhet të fokusohet në përmbushjen e qëllimeve të Planit të Veprimit. Në rastin tonë monitorimi duhet:

- të kontrolloj suksesin e riprodhimit të kolonisë së Pelikanit Kaçurrel
- të kontrolloj madhësinë e popullatës së Pelikanit Kaçurrel
- të kontrolloj nivelin e ndërgjegjësimit publik nëpërmjet intervistave me përfaqësues ose jo të zonës
- të kontrolloj numrin e publikimeve kërkimore që përmendin Pelikanin Kaçurrel

Dy kërkesat e para kanë lidhje direkte me zbatimin e Planit të Veprimit sepse varet nga faktorë afatshkurtër. Kërkesat e tjera varen nga faktorë afatgjatë dhe monitorimi i tyre duhet të fillojë vitin e 3-të të zbatimit të planit të veprimit.

### 12. Buxheti për zbatimin e planit

Zbatimi i këtij Plani Veprimi do të ketë nevojë për një shumë totale prej 755,100 Dollarësh. Buxheti është i ndarë në shtatë pjesë në përputhje me strukturën e aktiviteteve të paraqitura. Por duke pasur parasysh se realizimi i aktiviteteve kërkon njëkohësisht një administratë të mirëpajisur, në zërat buxhetorë është shtuar dhe ai i mbështetjes së strukturave administrative dhe OJQ-ve lokale. Veprimtaria e tyre ka qenë shumë domethënëse për rimëkëmbjen e Pelikanit kacurrel ne Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta ndaj dhe mbështetja ndaj këtyre strukturave duhet të vijojë.

Mbështetja e strukturave administrative dhe OJF-ve lokale përfshin blerjen e disa pajisjeve administrative, mjete transporti dhe varka për njësinë administrative. Buxheti ka parashikuar gjithashtu trainimin e stafit drejtues të administratës në çështjet që lidhen me menaxhimin.

Buxheti për zërat e tjerë është dhënë në mënyrë të përmblëdhur ndërkohë që detajet janë të paraqitura në Aneksin 1 në fund të këtij materiali.

Zërat buxhetorë të investimeve direkte, përkatësisht aktivitetet nën zërat **Përmirësim i politikave dhe legjislacionit dhe Menaxhim dhe ruajtje e habitateve,** kanë dhe peshën kryesore të buxhetit. Ndërkaq zërat e tjerë kanë një peshë më të ulët (shih Aneks 1 për më shumë detaje).

**Tabela 2. Buxheti (në Dollar)**

| Nr. | Aktivitetet | Buxheti Total (në 000 Euro) |
|---|---|---|
| 1 | **Mbështetje për administratën zbatuese dhe OJF-të lokale** | **34** |
| | Kompjuter dhe softëare | 3.5 |
| | GPS | 0.5 |
| | Pajisje te tjera terreni | 6 |
| | Mjete transporti (varka dhe motocikleta) | 24 |
| A | **Përmirësim i politikave dhe legjislacionit** | **158.5** |
| A.1. | Përmirësim i ligjit dhe zbatim i plotë i tij | 85 |
| A.2. | Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në ligatina | 13.5 |
| A.3. | Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar | 35 |
| A.4. | Studim i aspekteve socio-ekologjike dhe pëdorimi i analizave kosto-përfitim në procesin e vendimmarrjes | 25 |
| B. | **Menaxhim dhe ruajtje e habitateve** | **195.6** |
| B.1. | Stabilizim i habitateve të folezimit, të fjetoreve dhe vendeve të qëndrimit | 90 |
| B.2. | Nxitje e folezimit nëpërmjet përdorimit të strukturave artificilale | 20 |
| B.3. | Zbutje dhe ndalim i eutrofikimit dhe efekteve të tij | 85.6 |
| C. | **Monitorim i efektivave të Pelikanit kacurrel në Shqipëri dhe habitateve kritike te tij** | **277** |
| C.1. | Monitorim i Pelikanëve riprodhues, dimërues apo të përhershëm | 247 |
| C.2. | Monitorim i cilësisë së habitatit jetik për Pelikanin kacurrel | 30 |
| D. | **Edukim dhe Trainim** | **66** |
| D.1. | Edukim dhe rritje e ndërgjegjesimit të publikut | 29 |
| D.2. | Trainimi i mëtejshëm i stafit të ARZM-ve përgjegjëse, administrates vendore dhe grupeve të tjera të interesit | 37 |
| E. | **Nxitje e aktiviteteve të qëndrueshme të turizmit natyror** | **16** |
| F. | **Bashkëpunim i Administratës së Zonave të Mbrojtura me organizatat partnere** | **8** |
| | **TOTAL** | **755.1** |

## 13. Literatura e cituar


Barbieri, F., Bogliani, G. & Prigioni, C. 1986. Note sull'ornitofauna dell'Albania. *Rivista Italiana di Ornitologia* 56(1-2): 53-66.

Bernartzik, H. 1939. Der Riesen Pelicanen und ihre Kinder. Albanien, 3. Aufl. Viena.

Bino, T. 1998. *L'avifaune aquatique du systeme lagunaire méditerranéen de Karavasta (Albanie) et sa conservation*. Thèse de Doctorat, Université de Montpellier II Sciences et Techniques du Languedoc. 218p.

Bino, T. 1998. Nesting ëaterbirds of Karavasta complex. p. 38-43. *In* Zekhuis, M. & Tempelman, D. (editors). *Breeding birds of the Albanian ëetlands, spring 1996*. ËIËO - Report Nr. 64, Zeist.

Bino, T., Tourenq, C., Kayser, Y., Bussutil, S., Crozier, J., Dore, B.J. & Bego, F. 1996. *Recensement des oiseaux d'eau hivernants en Albanie (14 - 31 janvier 1996)*. Rapport de la Station Biologique de la Tour du Valat, Museum des Sciences de la Nature de Tirana, ASPBM et LIPU. 102pp.

Bino 2003. Action Plan for Dalmatian Pelican in Albania

BirdLife International. 2012. *Pelecanus crispus*. The IUCN Red List of Threatened Species 2012: e.T22697599A37969315. http://dx.doi.org/10.2305/IUCN.UK.2012-1.RLTS.T22697599A37969315.en. Doënloaded on 03 February 2016.

Catsadorakis, G., Crivelli, A., (2001) Nesting Habitat Characteristics and Breeding Performance of Dalmatian Pelicans in Lake Micro Prespa, NW Greece *Waterbirds: The International Journal of Waterbird Biology* Vol. 24, No. 3 (Dec., 2001), pp. 386-393

Catsadorakis, G., Onmu, O., Bugariu, S., Gul, O., Hatzilacou, D., Malakou, M., Michev, T., Naziridis, N., Rudenko, A., Saveljic, D., Shumka, S., Siki, M., Crivelli, A. (2015) Current status of the Dalmatian Pelican and the Great White Pelican populations of the Black Sea/Mediterranean flyway. Endangered Species Research. Vol. 27: 119–130, doi: 10.3354/esr00659

Crivelli AJ, Catsadorakis G, Hatzilacou D, Hulea D and others (2000) Status and population development of Great White Pelican *Pelecanus onocrotalus* and Dalmatian Pelican *Pelecanus crispus* in the Palaearctic. In: Yésu P, Sultana J (eds) Monitoring and conservation of birds, mammals and sea turtles of the Mediterranean and Black Seas. Environment Protection Department, Malta, p 38–46

Crivelli AJ, Catsadorakis G, Jerrentrup H, Hatzilacou D, Mitchev T (1991) Conservation and management of pelicans nesting in the Palearctic. In: Salathé T (ed) Conservation of migratory birds. ICBP Technical Publication No. 12, Cambridge, p 137−152

Crivelli, A. J. 1996. Action Plan for the Dalmatian Pelican (*Pelecanus crispus*). Pp 53-66. in B. Heredia, L. Rose and M. Painter, eds, *Globally threatened birds in Europe: action plans*. Strasbourg. Council of Europe and BirdLife International.

Crivelli, A. J., Marsili, L., Focardi, S. and Renzoni, A. 1999, Organochlorine compounds in pelicans nesting at lake Mikri Prespa, north-western Greece. Bull. Environ. Contam. Toxicol. 62: 383-389.

Gjiknuri, L. & Peja, N. 1992. Albanian lagoons: Their importance and economic development. *In* Finlayson, C. M., Hollis, G. E. and Davis, T. J. (Editors). *Managing mediterranean ëetlands and their birds*. IWRB Special Publication No. 20: 130-133.

Hagemeijer, W.J.M., Schepers, F. & Hallmann, B. 1993. *Wintering waterbirds in the coastal wetlands of Albania, 1993.* WIWO-Report Nr. 49.

Hilton-Taylor, C. (Compiler) (2000). 2000 IUCN Red List of Threatened Species. IUCN, Gland. Switzerland and Cambridge, UK. Xviii + 61pp.

Kallfa A, Bino T (2010) Reproduction biology of Dalmatian Pelican (*Pelecanus crispus)* in the Divjaka-Karavasta National Park. In: Proc 4th Int Sci Conf BALWOIS 2010. Ohrid, FYR of Macedonia, 25–29 May 2010, p 1–6

Kattinger, E. 1958. Beiträge zur Vogelkunde von Albanien (Shqipnia) und einiger jugoslaëischer Nachbargebiete. *Larus* XII. 123-217.

Kayser, Y., Bino, T. & Gauthier-Clerc, M. 1995. *Recensement des oiseaux d'eau hivernants en Albanie. 17 janvier - 7 février 1995.* Rapport de la Station Biologique de la Tour du Valat. 79pp.

Kayser, Y., Bino, T., Bego, F., Fremuth, Ë. & Jorgo. G. 1997. *Recensement des oiseaux d'eau hivernants en Albanie (3 - 19 Janvier 1997)*. Rapport de la Station Biologique de la Tour du Valat (France) et Museum des Sciences de la Nature (Tirana; Albanie). 52 pp.

Koci, K, Marku, E. & Dimareli, D. 1998. An overview on chlorinated hydrocarbons and their bioaccumulation in the biota of Karavasta lagoon. pp. 98-100. In. ECAT Tirana (eds*). Conservation and wise use of wetlands in the Mediterranean basin. Focus on the Kune-Vaini lagoon, Lezha, Albania.* 133p.

Lamani, F. 1989. Données sur la distribution et la zoogéographie des Pelecaniformes et des Ciconiiformes en Albanie. *Biologia Gallo-hellenica* 13: 111-118.

Lamani, F. et Puzanov, V. 1962. Inventarizimi i shpendeve te Shqiperise. *Buletini i Shkencave Natyrore* 3, 4. 87-101.

Marku, E. Koci, K. Bino, T. 2002. The involvement of egg toxic concentrations of chlorinated hydrocarbons in the conservation of the migratory species of Dalmatian Pelican *Pelecanus* crispus. Journal of Environmental Protection and Ecology 3, No2, pp. 425-434.

MoE., 2013: Urdher i Ministrit Nr. 146, dated 08.05. 2007 “Per Aprovimin e Listes se Kuqe te Flores dhe Faunes” e amenduar. Tirana, Albania

Urdher Lista e Kuqe e flores dhe faunes – Red list of threatened plant animal species of Albania. Tirana

Munari, C., Tesseri, U., Rossi, R, Misstri, M., (2009) The ecological status of Karavasta Lagoon (Albania): closing the stable door before the horse has bolted? Marine Environmental Research 69(1). 10-17

Peja, N., Sarigul, G. & Crivelli, A. J. 1996a. The Dalmatian Pelican, *Pelecanus crispus,* nesting in Mediterranean lagoons in Albania and Turkey. *Colonial Waterbirds* 19: 184-189.

Saveljic, D & Rubinic, B 2009. Report on Pelicans in Montenegro: Their regional link with Amvrakikos Gulf/ Mikri Prespa Lake (Greece) and Karavasta Lagoon / Narta Lagoon (Albania). UNEP RAC/SPA - Tunis, 2009 United Nations Environment Programme

Ticehurst, C. B. & Whistler, H. 1932. On the ornithology of Albania. *Ibis* 13-II: 40-93.

Vangeluwe, D., Beudels, M-O. & Lamani, F. 1996. Conservation status of Albanian coastal wetlands and their colonial waterbirds populations (Pelecaniformes and Ciconiiformes). *Colonial Waterbirds* 19: 81-90.

Whistler, H. 1936 Further observations from Albania. *Ibis* 13-IV: 335-356.

Zekhuist, M. J. & Tempelman, D. 1998. *Breeding waterbirds of the Albanian wetlands, spring 1996.* WIWO-report Nr. 64, Zeist.

**Aneksi 1. Buxheti i detajuar i Planit të Veprimit për Ruajtjen e Pelikani kacurrel (Pelecanus crispus) në Shqipëri për periudhën 2016-2021**

| Nr. | Aktivitetet | Periudha | V1 | V2 | V3 | V4 | V5 | Buxheti Total (në 000 Euro) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | **Mbështetje për administratën zbatuese dhe OJF-të lokale** | | | | | | | **34** |
| | Kompjuter, software dhe GPS | Viti 1-2 | 2 | 1.5 | | | | 4 |
| | Pajisje te tjera terreni | Viti 1-2 | 3 | 3 | | | | 6 |
| | Mjete transporti (varka dhe motocikleta) | Viti 1-2 | 12 | 12 | | | | 24 |
| **A** | **Përmirësim i politikave dhe legjislacionit (A.1. + A.2. + A.3. + A.4.)** | | | | | | | **158.5** |
| **A.1.** | **Përmirësim i ligjit dhe zbatim i plotë i tij** | | | | | | | **85** |
| A.1.a. | Kontroll strikt i zonës së folezimit në lagunën e Karavastasë | Muaji Janar-Korrik për cdo vit | 7 | 7 | 7 | 7 | 7 | 35 |
| A.1.b. | Kontroll i shtuar i aksesit te njeriut në zonat me rëndësi për Pelikanin kacurrel në Shqipëri e sidomos në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parkun Kombëtar të Prespës, veçanërisht në Liqenin e Prespës së Vogël, Liqenin e Shkodrës, Rezervuarin e Thanës, Kune-Vain dhe kompleksin lagunor të Nartës me qëllim krijimin e një mjedisi të pashqetësuar për pelikanët dhe llojet e tjera të shpendëve. | Gjatë gjithë kohës | 7 | 7 | 7 | 7 | 7 | 35 |
| A.1.c. | Ndalim i prerjes/djegies së kallamishteve në zonat kyçe të shpërndarjes së Pelikanit kacurrel (ana verilindore e Liqenit të Shkodrës, Kune-Vain dhe Liqenin e Prespës së Vogël.) | Gjatë gjithë kohës | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 15 |
| **A.2.** | **Promovim i zhvillimit të qëndrueshëm në ligatina** | | | | | | | **13.5** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.2.a. | Promovimi i konceptit të zonimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, Parkut Kombëtar të Prespës, Rezervës Natyrore të Menaxhuar të Shkodrës, Kune-Vainit, Patokut dhe Zonës së Pejzazhit të Mbrojtur Vjosë-Nartë. | Gjatë gjithë kohës | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 5 |
| A.2.b. | Promovim i ruajtjes dhe përfitimit të ndërsjellë me peshkatarët lokalë në Divjakë-Karavasta dhe Liqenin e Prespës së Vogël për rimëkëmbjen e kolonive folezuese të Pelikanit kacurrel. | Gjatë gjithë kohës | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 0.5 | 2.5 |
| A.2.c. | Lobim kundër planeve për zhvillim të turizmit të shoqëruara me tjetërsimin të habitateve kritike apo zonave qendore të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta. | Viti i I-rë | 3 | | | | | 3 |
| A.2.d. | Lobim kundër instalimit të infrastrukturës së shpimit të naftës në lagunën e Nartës me qëllimin e ruajtjes së habitatit dhe specieve. | Viti i I-rë | 3 | | | | | 3 |
| **A.3.** | **Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar** | | | | | | | **35** |
| A.3.a. | Përmirësim i bashkëpunimit me autoritetet e ruajtjes së biodiversitetit të Greqisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë nëpërmjet takimeve periodike të përvitshme midis autoriteteve përgjegjëse, institucioneve shkencore dhe OJF-ve të specializuara. | Viti I-rë e në vazhdim | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 10 |
| A.3.b. | Rritje e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shkencore të të katër vendeve në mbrojtje të biodiversitetit të ligatinave kyçe, veçanërisht në vendet trans-kufitare | Viti I-rë e në vazhdim | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 10 |
| A.3.c. | Promovimi i punës së përbashkët dhe shkëmbim të informacionit | Viti II-të e në vazhdim | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 5 |
| A.3.d. | Përmirësimi i bashkëpunimit mes OJQ-ve nga të katër vendet (Shqipëri, Mal i Zi, Maqedoni dhe Greqi) | Viti I-rë e në vazhdim | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 10 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A.4.** | **Studim i aspekteve socio-ekologjike dhe pëdorimi i analizave kosto-përfitim në procesin e vendimmarrjes** | | | | | | | **25** |
| A.4.a. | Ndërmarrja e studimeve socio-ekologjike në zonat e rëndësishme të Pelikanit kaçurrel, në mënyrë që të identifikohen konfiktet ekzistuese ose të mundshme midis njerëzve dhe pelikanëve | Viti 2-3 | | 3 | 2 | | | 5 |
| A.4.b. | Ndërmarrja e një analize kosto-përfitim me qëllim identifikimin dhe promovimin e përfitimeve ekonomike që burojnë nga mbrojtja e Pelikanit kacurrel | Viti 3-4 | | | 5 | 5 | | 10 |
| A.4.c. | Realizimi i një studimi mbi shërbimet që ofron ekosistemi për të identifikuar vleren e saktë dhe të ardhurat dhe metoden e përshtatshme | Viti 3-4 | | | 5 | 5 | | 10 |
| **B.** | **Menaxhim dhe ruajtje e habitateve (B.1. + B.2. + B.3.)** | | | | | | | **195.6** |
| **B.1.** | **Stabilizim i habitateve të folezimit, të fjetoreve dhe vendeve të qëndrimit** | | | | | | | **90** |
| B.1.a. | Kryerja e studimit ndërdisiplinor për projektimin teknik të strukturave të stabilizimit dhe instalimeve përfshirë modelimin e efektit të valëve dhe rrymave në erodimin e ishujve të folezimit. | Viti 2-3 | | 20 | 20 | | | 40 |
| B.1.b. | Zbatimi i skemës pilot të stabilizimit në lagunën e Karavastasë. | Viti 3-4 | | | 20 | 30 | | 50 |
| **B.2.** | **Nxitje e folezimit nëpërmjet përdorimit të strukturave artificilale** | | | | | | | **20** |
| B.2.a. | Furnizm i me degë, shkarpa dhe kripth i ishullit të folezimit ne Divjakë-Karavasta. | 15 Nëntor- 15 Dhjetor të cdo viti | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 5 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| B.2.b. | Sigurim i strukturave të përshtatshme artificiale ose materiale për të lehtësuar riprodhimin ose qëndrimin (në Shkodër, Prespë e Vogël, Kune-Vain) në varësi të nevojës dhe mundësive për riprodhim të Pelikanëve | Viti 2-4 | | 5 | 5 | 5 | | 15 |
| **B.3.** | **Zbutje dhe ndalim i eutrofikimit dhe efekteve të tij** | | | | | | | **85.6** |
| B.3.a. | Kontrolli/Harmonizimi i skemës së ujit në hyrje dhe dalje në kanalet e komunikimit në lagunën Karavastasë (si detare dhe kontinentale) | Viti 2-5 | | 10 | 10 | 10 | 10 | 40 |
| B.3.b. | Kryerja e studimeve për vlerësimin e gjendjes ekologjike të trupave ujorë dhe burimet e ndotjes që ndikojnë në integritetin e ekosistemeve ujore | Viti 2-4 | | 15 | 15 | 15 | | 45 |
| B.3.c. | Bashkëpunim i strukturave menaxhuese të zonave të mbrojtura me autoritetet qeveritare për të arritur vendosjen e një sistemi të integruar të trajtimit të ujërave të zeza dhe menaxhimit të mbetjeve të ngurta | Viti 2-4 | | 0.2 | 0.2 | 0.2 | | 0.6 |
| **C.** | **Monitorim i efektivave të Pelikanit kacurrel në Shqipëri (C.1. + C.2.)** | | | | | | | **277** |
| **C.1.** | **Monitorim i Pelikanëve riprodhues, dimërues apo të përhershëm** | | | | | | | **247** |
| C.1.a. | Monitorim i përvitshëm i evolucionit të numrit të çifteve riprodhuese dhe suksesit të riprodhimit të kolonisë ekzistuese dhe kolonive të tjera të mundshme. | Janar-Korrik i cdo viti | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 15 |
| C.1.b. | Monitorim i Pelikanëve dimërues, mundësisht në zonat e fjetjes apo të qëndrimit në secilën IBA | Fillim Dhjetor, fund Dhjetor dhe mes Janar | 3 | 3 | 3 | 3 | 3 | 15 |
| C.1.c. | Monitorim i Pelikanëve të sëmurë apo të ngordhur dhe identifikimi i shkaqeve të ngordhjes. | Gjatë gjithë kohës | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 5 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| C.1.d. | Matja e përqëndrimit të pesticideve dhe metaleve të rënda tek vezët e Pelikanëve | Viti 2-5 | | 3 | 3 | 3 | 3 | 12 |
| C.1.e. | Ngritje e një qendre rehabilitimi për individët e sëmurë të Pelikanit kacurrel në Divjakë-Karavasta. | Viti 2-3 | | 100 | 100 | | | 200 |
| **C.2.** | **Monitorim i cilësisë së habitatit jetik për Pelikanin kacurrel** | | | | | | | **30** |
| C.2.a. | Monitorimin periodik i cilësisë së ujit nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit në përputhje me Direktivën Evropiane të Ujit | Cdo trimestër - Viti 1-5 | 2 | 2 | 2 | 2 | 2 | 10 |
| C.2.b. | Monitorimi i kapjes së peshkut në zonat kyç të Pelikanit kaçurrel (Karavasta, Nartë, Shkodër, Kune-Vain, Patok, Thanë, Butrinti etj). | Viti 2-5 | | 2 | 2 | 2 | 2 | 8 |
| C.2.c. | Monitorim i cilësisë së habitateve ujore nëpërmjet bioindikatorëve si Lundërza (Lutra lutra) etj. | Viti 2-5 | | 3 | 3 | 3 | 3 | 12 |
| **D.** | **Edukim dhe Trainim (D.1. + D.2.)** | | | | | | | **66** |
| **D.1.** | **Edukim dhe rritje e ndërgjegjesimit të publikut** | | | | | | | **29** |
| D.1.a. | Informimi i gjerë i përdoruesve të burimeve ujore, grupeve të interesit në nivel lokal dhe kombëtar, rreth rëndësisë së ruajtjes dhe rimëkëmbjes së Pelikanit kacurrel | Viti 3-5 | | | 1 | 1 | 1 | 5 |
| D.1.b. | Organizmi i fushatave ndërgjegjësuese publike me gjuetarët, peshkatarët, komunitetet lokale, operatorët turistikë, institucionet qeveritare që janë pjesë e mbrojtjes së Pelikanit kaçurrel | Viti 3-5 | | | 2 | 2 | 2 | 6 |
| D.1.c. | Përgatitja e publikimeve (fletpalosje, broshurave, posterave, etj.) rreth rëndësisë kombëtare dhe ndërkombëtare të zonave të shpërndarjes se Pelikanit kacurrel | Viti 2-5 | | 2 | 2 | 2 | 2 | 8 |
| D.1.d. | Përgatitja e një filmi dokumentar rreth situatës aktuale të Pelikanit kaçurrel dhe nevojës për përmirësim | Viti 2-3 | | 5 | 5 | | | 10 |
| **D.2.** | **Trainim i mëtejshëm i stafit të ARZM-ve përgjegjëse, administrates vendore dhe grupeve të tjera të interesit** | | | | | | | **37** |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| D.2.a. | Trainim i stafit të ARZM-ve në lidhje me edukimin mjedisor, ruajtjen dhe menaxhimin e shpendëve, jetës së egër në përgjithësi dhe ligatinat | Viti 2-4 | | 3 | 3 | 3 | | 9 |
| D.2.b. | Trainimi i OJF-ve dhe grupeve të tjera të interesit për ruajtjen e natyrës duke u përqëndruar veçanërisht në ruajtjen e Pelikanit kacurrel | Viti 2-4 | | 2 | 2 | 2 | | 6 |
| D.2.c. | Zhvillimi i një moduli trainimi për stafin ARZM-s përgjegjës për zbatimin e ligjit mbi rregullat dhe rregulloret që lidhen me mbrojtjen e Pelikanit Kaçurrel. | Viti 2-3 | | 2 | 2 | | | 4 |
| D.2.d. | Rritja e kapaciteteve teknike të punonjësve të zonave të mbrojtura mbi monitorimin e shpendëve, pajisjet e menaxhimit të rëndësishme për ruajtjen e Pelikanit kaçurrel, kontrollin e grabitqarëve, minimizimin e ndërhyrjeve nga njerëzit dhe shqetësimeve të tjera të veçanta dhe stabilizimin e aktiviteteve bregdetare. | Viti 2-3 | | 5 | 5 | | | 10 |
| D.2.e. | Përgatitja e programeve specifike të trainimit për anëtarët e OMP-ve mbi rritjen e kapaciteteve në menaxhimin | Viti 2-5 | | 2 | 2 | 2 | 2 | 8 |
| **E.** | **Nxitje e aktiviteteve të qëndrueshme të turizmit natyror** | | | | | | | **16** |
| E.1.a. | Organizimi i trainimit të guidave natyrore dhe sigurimi me informacionin të nevojshëm për edukimin mjedisor | Viti 2-4 | | 2 | 2 | 2 | | 6 |
| E.1.b. | Sigurimi i tureve të organizuara nga të paktën 10 operatorë turistik të specializuar në turizmin e botës së egër | Viti 2-5 | | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 |
| E.1.c. | Hartimi dhe botimi i një manuali "Si të sillemi në zonat ku jeton Pelikani kaçurrel" | Viti 2-3 | | 2 | 4 | | | 6 |
| **F.** | **Bashkëpunim i Administratës së Zonave të Mbrojtura me organizatat partnere** | | | | | | | **8** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| F.1.a. | Bashkëpunim i ngushtë me partnerët për të promovuar turizmin natyror dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e Pelikanit kacurrel për efektet pozitive të këtij simboli në rritjen ekonomike të zonave ku ai ndodhet. | Viti 2-5 | | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 |
| F.1.b. | Bashkëpunimi efektiv me shërbimin e veterinarisë për të siguruar një përgjigje në kohë mbi identifikimin e sëmundjeve dhe rehabilitimin e shpendëve. | Viti 2-5 | | 1 | 1 | 1 | 1 | 4 |
| | **TOTAL** | | **64** | **241.2** | **258.7** | **130.7** | **63.5** | **755.1** |

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"

Çmimi 336 lekë